



# *Raporti Vjetor* *2019*



*Fushë Kosovë*  
*Shkurt 2020*



**INFRAKOS**

27/02/2020

Mbështetur në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike Nr. 03 / L-087, Neni 31, Paragrafi 31.3 si dhe në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pika 28, paragrafi 28.6 dhe 28.7 Bordi i Drejtorëve i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës Sh.A “INFRAKOS” në mbledhjen e BoD me nr-91 (nëntëdhjetë e një) të mbajtur me datën 27/02/2020 mori këtë:

**VENDIM:**

- I. **Aprovohet Raporti Vjetor për vitin 2019 i Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A „INFRAKOS”.**
- II. **Sekretari i Korporatës i Ndërmarrjes Publike Sh.A „INFRAKOS” obligohet që ta procedoi Raportin Vjetor për vitin 2019 te Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike brenda afateve ligjore.**
- III. **Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.**

**Kryesuesi i BoD**  
**z. Erver Aruqaj**



**Kryeshef Ekzekutiv**  
**Agron Thaçi**

**Vendimi i dërgohet:**

- Aksionarit - NJPMNP
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Sekretarit të Kompanisë
- Arkivit

## ***Përmbajtja***

<b>01</b>	<i><b>Fjala hyrëse për aksionarin</b></i>	Mesazhi i kryesuesit të bordit të drejtorëve Fjala hyrëse e kryeshefit ekzekutiv	4 6
<b>02</b>	<i><b>Raporti i kryesuesit të BD</b></i>	Raporti i kryesuesit të bordit të drejtorëve	9
<b>03</b>	<i><b>Raporti i KE-së</b></i>	Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv të INFRAKOS-it	15
<b>04</b>	<i><b>Ngjarjet kryesore të vitit</b></i>	Ngjarjet kryesore të vitit Arritjet kryesore gjatë vitit 2019 Çështjet kyçe gjatë vitit 2019	22 23 24
<b>05</b>	<i><b>Performanca operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës</b></i>	Departamenti i komunikacionit Departamenti i MLH-së Departamenti i VET-së Zyra e planifikimit dhe zhvillimit Departamenti i administratës Departamenti për pronë dhe standarde Zyra ligjore Departamenti për MP, MSHMP dhe TI Kontrollori i brendshëm	28 35 42 49 51 55 58 60 63
<b>06</b>	<i><b>Pasqyrat e performancës financiare dhe rezultatet</b></i>	Performanca financiare e INFRAKOS-it Të hyrat e planifikuara dhe ato të realizuara Shpenzimet e planifikuara dhe ato të realizuara Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve	66 67 69 70
<b>07</b>	<i><b>Progresi me planin e biznesit</b></i>	Pasqyra e progresit në zbatimin e PB-së Progresi i objektivave kryesore strategjike Ndryshimet gjatë aktiviteteve	73 73 76
<b>08</b>	<i><b>Shpenzimet kapitale dhe projektet</b></i>	Projektet kapitale Komentet mbi realizimin e projekteve	78 79
<b>09</b>	<i><b>Perspektiva për vitin e ardhshëm</b></i>	Objektivat kryesore sipas PB për vitin 2015 Ndryshimet nga PB i vitit paraprak	81 82
<b>10</b>	<i><b>Rreziqet e së ardhmes</b></i>	Rreziqet kryesore në dy vitet e ardhshme Komentimi i rreziqeve. Si të vepohet	84 85 87

# 1

## ***Fjala hyrëse për aksionarin***

---

<i>Mesazhi i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve</i>	<i>4</i>
<i>Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv</i>	<i>6</i>

---

## *Mesazhi i kryesuesit të bordit të drejtorëve*

---



### *Z. Enver Aruqaj*

*Kryesues i Bordit të Drejtorëve  
të Infrastrukturës së  
Hekurudhave të Kosovës Sh.A -  
INFRAKOS*

*Të nderuar aksionarë,*

*Që nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës Sh.A në vitin 2011 e deri më sot, INFRAKOS-i asnjëherë nuk ka pasur vit më të vështirë financiar sesa vitin 2019. Ne kemi paralajmëruar shumë herë të gjitha institucionet përgjegjëse për gjendjen tejet të vështirë financiare të kompanisë, duke propozuar dhe sugjeruar mënyrën se si duhet të veprohet, por për fat të keq edhe gjatë vitit 2019 nuk gjetëm përkrahje. Për ne është i pakuptueshëm fakti se edhe tetë vite pas ndarjes akoma nuk është nënshkruar marrëveshja pesëvjeçare financiare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it, marrëveshje kjo e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063.*

*Në mars të vitit 2019 Bordi i Drejtorëve ka miratuar marrëveshjen në fjalë të hartuar nga menaxhmenti i INFRAKOS-it dhe e njëjta i është dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit si dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për miratim dhe nënshkrim. Asokohe Bordi kishte autorizuar Kryeshëfin Ekzekutiv të kompanisë që këtë marrëveshje ta diskuton dhe sqaron me ministritë përkatëse gjë që edhe është bërë. Finalja e kësaj dihet, marrëveshja nuk ishte nënshkruar e pasojat tani më janë shumë të qarta, INFRAKOS-i gjendet buzë kolapsit financiar.*

*Për të qenë ironia më e madhe, për gjendjen e vështirë financiare në të cilën gjendemi, ne nuk jemi fajtorë dhe nuk mbajmë kurrfarë përgjegjësie, sepse të hyrat tona kryesore nuk varen nga ne por varen nga operatorët e*

transportit hekurudhor, atij publik TRAINKOS dhe atij privat RAILTRANS, të cilët e bëjnë pagesën për shfrytëzimin e traseve hekurudhore për qarkullimin e trenave. E kur kihet parasysh se Ministria e Infrastrukturës ka bërë zbritjen e pagesave të qasjes në binarë dhe duke mos e bërë subvencionimin e diferencës ndërmjet kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe të hyrave të realizuara nga pagesat e qasjes në binarë, atëherë është shumë e qartë se pse jemi në këtë gjendje. Përveç kësaj, që nga viti 2012 e deri më sot ka pasur rënie të transportit të udhëtarëve (duke u eliminuar qarkullimi i disa trenave të udhëtarëve) e në veçanti rënie të transportit të mallrave gjë që i ka reduktuar edhe më shumë të hyrat e INFRAKOS-it.

Marrë parasysh këtë që u tha më lartë e vetmja mundësi për funksionim të mëtejshëm të kësaj kompanie mbetet që të nënshkruhet kontrata pesëvjeçare financiare e paraparë me ligj, ashtu që njëherë e përgjithmonë të zgjidhet çështja e financimit të INFRAKOS-it. INFRAKOS asnjëherë nuk ka kërkuar dhe nuk kërkon lëmoshë, por kërkon që secili institucion t'i bartë përgjegjësitë e veta. Është e ditur se nënshkrimi i kontratës financiare pesëvjeçare kërkohet edhe me Direktivat e Bashkësisë Evropiane, është obligim i cili është kërkuar në vazhdimësi nga Observatori i Transportit për Evropën Jug Lindore (SEETO) dhe mbetet obligim i cili kërkohet me Traktatin për Themelimin e Komunitetit të Transportit për Vendet e Ballkanit Perëndimor, nënshkruar i të cilit dokument është edhe Kosova. Sa për informim praktika e nënshkrimit të kontratave të tilla ka vite të tëra që zbatohet në BE, ndërsa vitet e fundit edhe në vendet e rajonit.

Përkundër problemeve dhe vështirësive financiare të përmendura më sipër, Bordi i Drejtorëve ka pasur angazhime të vazhdueshme në mbikëqyrjen e zbatimit të detyrave të përcaktuara me Planin e Veprimit të kompanisë dhe realizimin e politikave të përcaktuara me Planin e Biznesit për vitin 2019, qoftë sa i përket zbatimit të akteve ligjore dhe rregulloreve përkatëse, qoftë sa i përket mirëmbajtjes së infrastrukturës, rregullimit të komunikacionit hekurudhor, menaxhimit të pronës dhe ofrimit të shërbimeve tjera përkatëse, apo qoftë edhe në monitorimin e zbatimit të projekteve zhvillimore të kompanisë.

Pengesat dhe vështirësitë eventuale janë tejkaluar në ecje e sipër dhe përkundër vështirësive financiare, gjatë tërë vitit është arritur që të ruhet funksionimi i kompanisë dhe detyrat e përcaktuara të realizohen me sukses. Për këtë arsye unë në fund në emër të Bordit të Drejtorëve do të dëshiroja që të falënderoj të gjithë menaxhmentin dhe stafin tjetër të INFRAKOS-it për angazhimin e tyre në realizimin e detyrave të parapara.

Dhe krejtësisht në fund dua të konstatoj se hekurudha paraqet boshhtin kurrizor për zhvillimin ekonomik të vendit, andaj investimi në hekurudhë do të thotë investim në ardhmërinë e vendit.

## *Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv*

---



### *Z. Agron Thaçi*

*Kryeshef Ekzekutiv i  
Infrastrukturës së  
Hekurudhave të Kosovës Sh.A -  
INFRAKOS*

*Të nderuar/a zonja dhe zotërinj,*

*Vitin 2019 e kaluam me shumë sfida të cilat edhe pse të parashikuara dhe të pritura se do të ndodhin menaxhmentit të INFRAKOS-it i morën energji të mëdha. Tanimë kuptohet se sfida kryesore e cila akoma na përcjellë ndërlidhet me gjendjen tepër të vështirë financiare e cila pa fajin tonë e përcjellë këtë kompani qe disa vite, por e përkeqësuar në maksimum dy tri vitet e fundit.*

*Rrjeti Hekurudhor i Kosovës i menaxhuar nga INFRAKOS-i, edhe në vitin 2019 ishte i sigurt për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, arritje kjo falë angazhimeve tona të vazhdueshme gjatë tërë vitit. Përveç ofrimit të shërbimeve për operatorin hekurudhor publik TRAINKOS dhe operatorin privat RAILTRANS, një angazhim maksimal është bërë edhe për ofrimin e shërbimeve të patundshmërisë dhe shërbimeve tjera për klientët tanë. Andaj, si rezultat i këtyre angazhimeve, kënaqësia e klientëve tanë ka qenë dhe mbetet në nivele relativisht të larta, kënaqësi kjo e testuar dy herë brenda vitit dhe me pjesëmarrje të qindra klientëve.*

*Edhe pse me pjesë rezervë të pamjaftueshme, me një mbështetje financiare tepër të vogël nga shteti, ne gjatë tërë vitit e bëmë të pamundurën që linjat hekurudhore të cilat janë në operim t'i mirëmbajmë pa ndërprerë duke garantuar qarkullim të sigurt të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave. Departamentet tona të mirëmbajtjes e kryen me sukses misionin e*

tyre, duke filluar nga Departamenti i Komunikacionit, Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore, e deri te Departamenti i Sinjalizimit, Telekomunikacionit dhe Energjetikës, andaj operatorëve të transportit hekurudhor gjatë tërë vitit, për çdo orë dhe minutë u janë ofruar shërbime cilësore për realizimin e transportit hekurudhor. Për më tepër, intervenimi i menjëhershëm në evitimën e pengesave ka bërë që gjatë tërë vitit të mos kemi asnjë minutë vonesë në qarkullimin e trenave për shkak të INFRAKOS-it. Pra, puna e palodhshme e të gjithëve ka bërë që me shumë sukses të bëhet organizimi i qarkullimit të trenave duke ofruar shërbime njëzet e katër orëshe për të gjitha llojet e trenave.

Këtu nuk kanë mbetur anash as departamentet apo shërbimet tjera të kompanisë, duke filluar nga patundshmëria, financat, prokurimi, zyra ligjore, administrata, planifikim zhvillimi, logjistika, mirëmbajtja e objekteve e deri te zyra e informimit, duke realizuar kështu secili detyrat e veta të parapara me planin e veprimit të kompanisë. Është e kuptueshme se ndonjëherë ka pasur edhe ngecje të vogla, por të cilat janë riparuar menjëherë dhe si rezultat nuk ka munguar suksesi i pritur.

Një punë e vazhdueshme është bërë edhe në hartimin dhe dërgimin me kohë tek institucionet përgjegjëse të të gjitha raporteve të punës: mujore, kuartale, gjashtëmujore dhe atij vjetor, pastaj raporteve financiare, planit të biznesit, planit të veprimit, raportit të kënaqshmërisë dhe informatave tjera të kërkuara nga cilido prej këtyre institucioneve. Në veçanti është punuar në mënyrën më profesionale të mundshme për ofrimin e të gjitha informatave të kërkuara nga Observatori i Transportit për Evropën Jug Lindore (SEETO) dhe më vonë nga Komuniteti i Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor lidhur me agjendën e konektivitetit.

Ne kemi potencuar disa herë se rrjeti hekurudhor ekziston për të ofruar vlerë të lartë për taksapaguesit dhe konsumatorët. Kjo kërkon identifikimin e saktë të mundësive financiare të kompanisë dhe investimeve afatgjata në infrastrukturën hekurudhore. Për këtë arsye orientimi i jonë ka qenë shumë i qartë drejt përmirësimit të infrastrukturës hekurudhore dhe gjendjes financiare të kompanisë, duke bërë maksimumin për realizimin e projekteve infrastrukturore të cilat janë me rëndësi jetike për kompaninë.

Ne me kënaqësi mund të themi se në vitin 2019 ka filluar rehabilitimin gjeneral i fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit), si dhe ka përfunduar projekt dizajni detaj teknik për fazën e dytë Fushë Kosovë - Mitrovicë. Përveç këtyre projekteve, gjatë vitit 2019 ka vazhduar realizimi i projekt dizajnit preliminar për rehabilitimin gjeneral të Linjës së 7-të hekurudhore (Fushë Kosovë - Podujevë), si dhe studimi i fizibilitetit për linjën e re hekurudhore (Prishtinë - Aeroporti i Prishtinës). Prandaj, këto projekte tregojnë angazhimin tonë maksimal për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës hekurudhore, ashtu që kjo

*infrastrukturë t'i plotësojë kriteret e kërkuara të interoperabilitetit, kritere këto të kërkuara me direktivat e BE-së.*

*Viti 2019 është përcjellë me sfida të mëdha sa i përket rënies drastike të të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet për shkak të rënies së transportit të mallrave dhe ndërprerjes së mëhershme të qarkullimit të një numri të caktuar të trenave të udhëtarëve nga ana e TRAINKOS-it, si dhe mos subvencionimit të INFRAKOS-it të kërkuar nga qeveria. Ne nuk do të dëshironim kurrë që ky vit të përsëritet, andaj edhe kërkohet nga institucionet përgjegjëse që t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore rreth financimit ashtu që INFRAKOS-i të mos vjen në situatë që të detyrohet t'i ndërpres operimet e veta.*

*Për fund, unë dua që t'i falënderoj të gjithë punonjësit e INFRAKOS-it për angazhimin e tyre në realizimin e detyrave, stafin menaxhues të kompanisë, bordin e drejtorëve për mbështetjen e pakursyer, si dhe të gjithë akterët tjerë të lidhur në çfarëdo mënyre me INFRAKOS-in me premtimin se ne do të angazhohemi maksimalisht edhe në vitet në vijim.*

# 2

## ***Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve***

---

<i>Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes</i>	10
<i>Të hyrat dhe shpenzimet</i>	11
<i>Kreditë</i>	13
<i>Projektet kapitale</i>	13
<i>Pagesat e dividendës</i>	13
<i>Të dhënat për drejtorët jo ekzekutiv</i>	14
<i>Takimet e bordit</i>	14
<i>Komitetet e bordit</i>	15
<i>Informacione tjera</i>	15
<i>E ardhmja</i>	16

---

## **Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes**

Viti 2019 ka qenë një vit i angazhimeve kontinuale i menaxhmentit dhe të gjithë punonjësve tjerë në mirëmbajtjen e rrjetit hekurudhor, ndërsa një punë shumë e madhe është bërë edhe në zhvillimin e projekteve kapitale infrastrukturore. Në këtë vit ka filluar rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut), ndërsa po ashtu është kryer edhe projekt dizajni për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë). Pa dyshim që një punë e madhe sa i përket projekteve zhvillimore është bërë edhe me vazhdimin e punëve në realizimin e projekt dizajnit preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë), si dhe në realizimin e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e linjës së re hekurudhore Prishtinë - Aeroporti i Prishtinës). S'do mend se projekti i rehabilitimit financohet nga BERZH-i, BEI-ja dhe grantet e BE-së, ndërsa që të gjitha projektet tjera të përmendura këtu janë financuar nga grantet e BE-së. Kjo paraqet një sukses të madh të INFRAKOS-it duke dëshmuar kështu angazhimin e vazhdueshëm të menaxhmentit për realizimin e projekteve zhvillimore.

Duke lexuar raportet, informatat dhe dokumentet tjera të përgatitura nga menaxhmenti, si dhe duke monitoruar në vazhdimësi punën e realizuar në kompani, konstatimi i Bordit të Drejtorëve të INFRAKOS-it është se performanca e kompanisë gjatë vitit 2019 ka qenë në nivel të kënaqshëm. Angazhimi i të gjithë punonjësve të INFRAKOS-it ka qenë i orientuar drejt mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, duke ofruar kështu shërbime cilësore, me një siguri të lartë, transparencë të plotë dhe efikasitet të madh për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve tona. Por, viti 2019 ka qenë edhe viti i vështirësive tepër të mëdha financiare nëpër të cilat ka kaluar INFRAKOS-i, vështirësi këto të akumuluar edhe nga vitet paraprake për shkak të rënies së transportit të mallrave dhe ndërprerjes së qarkullimit të një numri të trenave të udhëtarëve (për çka është përgjegjës Operatori Publik i Transportit Hekurudhor – TRAINKOS dhe ai privat RAILTRANS), si dhe mos pagesës së subvencionit të kërkuar nga shteti për mbulimin e diferencës së të hyrave ndërmjet kostos direkte për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore dhe pagesave të qasjes në rrjet nga operatorët e transportit hekurudhor.

Duke parë situatën tepër të vështirë financiare, Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e INFRAKOS-it si prioritet numër një dhe objektivë kryesore gjatë vitit 2019 e ka pasur funksionimin e kompanisë. Me një angazhim maksimal të të gjithëve, përkundër sfidave tejet të mëdha të natyrave të ndryshme, kjo objektivë është realizuar me sukses. Por, e kamë thënë edhe në fjalën time të hyrjes se nëse nuk nënshkruhet kontrata financiare pesëvjeçare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it e cila parashihet me ligj, atëherë kjo kompani nuk do të mundet të funksionoj më dhe do të detyrohet ta ndërpres operimin.

Aktivitetet e Bordit të Drejtorëve të INFRAKOS-it gjatë tërë vitit 2019 kanë qenë shumë të mëdha dhe të orientuara kryekëput në drejtim të funksionimit të kompanisë, por edhe për zhvillimet në të ardhmen. Analizat e mirëfillta dhe marrja e masave adekuate konform situatave aktuale në të cilën gjendej kompania ka ndikuar që mos të bllokohet funksionimi normal i kësaj kompanie. Bordi i Drejtorëve gjithnjë ka marrë vendimet e nevojshme ashtu që të zbatohen politikat e përcaktuara paraprakisht me planin e biznesit drejt realizimit të detyrave dhe projekteve

zhvillimore ashtu që kompania të ketë një performancë pozitive, gjithnjë duke anashkaluar problemin financiar i cili shumë pakë varet nga INFRAKOS-i, por është si pasojë e akterëve tjerë.

Një punë e palodhshme është bërë edhe në vazhdimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet INFRAKOS-it dhe institucioneve të ndryshme vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Bordi gjithnjë e ka përkrahur dhe inkurajuar menaxhmentin që të zhvillojnë raporte të mira me të gjitha institucionet në interes të zhvillimit të rrjetit hekurudhor dhe kompanisë në tërësi.

Gjatë vitit 2019 në veçanti është bërë përmbushja e obligimeve ligjore të cilat i ka Bordi ndaj aksionarit. Të gjitha kërkesat e aksionarit janë marrë me prioritet të lartë dhe me kohë është dhënë informacioni i kërkuar në secilën prej tyre. Këtu bëjnë pjesë edhe raportimet e rregullta, vlerësimet e performancës, testimi i kënaqshmërisë së klientëve dhe dokumentet tjera të cilat bordi në mënyrë të rregullt i ka dërguar tek aksionari.

## **Të hyrat dhe shpenzimet**

Të hyrat kryesore të INFRAKOS-it realizohen nga ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët hekurudhor, e që në rastin tonë konkret është operatori publik i transportit TRAINKOS i cili e bënë transportin e udhëtarëve dhe mallrave dhe operatori privat RAILTRANS i cili merret me transportin e mallrave. Pra të hyrat kryesore të INFRAKOS-it krijohen nga pagesat e qasjes në binarë të cilat i bëjnë këto dy kompani për shfrytëzimin e traseve hekurudhore. Të hyrat e dyta për nga vlera krijohen nga dhënia e pronës (lokaleve, banesave në stacione, depove dhe hapësirës së hapur) me qira. Një sasi e konsiderueshme e të hyrave realizohet nga mirëmbajtja e binarëve industrial, si dhe ofrimi i shërbimeve tjera të ndryshme për shfrytëzuesit publik apo privat.

Përderisa performanca afariste e INFRAKOS-it në vitin 2019 ka qenë e kënaqshme duke arritur që infrastruktura hekurudhore dhe ofrimet e shërbimeve të transportit hekurudhor të mirëmbahen në nivelin e duhur, performanca financiare (pa fajin e INFRAKOS-it) ka qenë tepër e dobët. Kur themi këtë bazohemi në rënien e vazhdueshme të të hyrave nga pagesat e planifikuara të qasjes në rrjet, për shkak se kishte një rënie të transportit të mallrave dhe mos subvencionimit të kërkuar nga shteti. Sa i përket të hyrave të cilat varen nga INFRAKOS-i (të hyrat nga patundshmëria dhe të hyrat tjera), të hyrat nga patundshmëria kanë pasur një rënie të vogël krahasuar me buxhetin, ndërsa të hyrat tjera kanë pasur një rritje të madhe. Kjo tregon se angazhimi i jonë nuk ka munguar, por gjendja e vështirë financiare në të cilën ndodhet INFRAKOS-i është si pasojë e mosrealizimit të detyrave të parapara nga të tjerët, gjë që është për keqardhje të madhe. Ne nuk mund të pretendojmë që të kemi përmirësim të kësaj gjendje financiare pa intervenimin, respektivisht pa përmbushjen e detyrimeve të cilat qeveria i ka ndaj INFRAKOS-it.

Në tabelën vijuese është bërë paraqitja e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara të INFRAKOS-it për vitin 2019, duke i krahasuar ato me planin e biznesit (buxhetin) e vitit 2019, si dhe me ato të vitit 2018.

<b>Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve</b>	<b>Realizimi 2018</b>	<b>Planifikimi 2019</b>	<b>Realizimi 2019</b>
<b>Të hyrat</b>	1,936,183.31	3,678,000.00	2,576,773.40
<b>Shpenzimet</b>	2,505,844.69	3,377,000.00	2,560,557.16
<b>Diferenca</b>	- 569,661.38	301,000.00	16,216.24

*Nga tabela e mësipërme shihet se të hyrat e INFRAKOS-it për periudhën kohore (janar – dhjetor) 2019 janë 2,576,773.40 €, që krahasuar me planifikimin 3,678,000.00 €, janë për 29.94 % më të ulëta se sa të hyrat e planifikuara, ndërsa krahasuar me vitin 2018, të hyrat e INFRAKOS-it janë për 640,590.09 € apo 33.09 % më të mëdha. Pra, bazuar në të dhënat e mësipërme mund të konstatojmë se rënia e transportit dhe mos subvencionimi nga qeveria na ka sjellë në një situatë tejet të vështirë financiare, duke e përkeqësuar edhe më shumë gjendjen paraprake.*

Duke marrë parasysh që të hyrat e INFRAKOS-it janë realizuar përafërsisht sipas parashikimeve tona por nuk e kanë mbërrirë koston e shpenzimeve të parapara, atëherë bordi në bashkëpunim me menaxhmentin kanë vendosur që shpenzimet e kompanisë të zvogëlohen në minimumin e mundshëm. Kjo është bërë që të kemi një mundësi të funksionimit të kompanisë, por gjithnjë duke ruajtur nivelin bazik të sigurisë së qarkullimit të trenave. Kështu që shpenzimet totale të INFRAKOS-it për vitin 2019 kanë qenë 2,560,557.16 €, që duke i krahasuar me shpenzimet e planifikuara 3,377,000.00 €, del se janë shpenzuar 816,442.84 € më pak apo shprehur në përqindje 24.18% më pak. Krahasuar me vitin 2018 ne kemi shpenzuar 54,712.47 € apo 2.18 % më shumë.

Në të hyrat dhe shpenzimet e paraqitura më lartë nuk janë llogaritur edhe të hyrat e shtyra dhe amortizimi, kështu që sikur të merren parasysh të hyrat e shtyra në vlerën prej 1,018,707.28 €, amortizimi në vlerën prej 1,197,807.40 € dhe shpenzimet tjera financiare në vlerën prej 740.53 €, atëherë do të kemi një rezultat operativ negativ në vlerën prej – 163,624.41 €. Po e ritheksojmë se ky rezultat negativ është pa fajin e INFRAKOS-it.

Vlen të përmendet se sipas llogarive tona kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës për vitin 2019 ka qenë 3,135,000.00 €, ndërsa të hyrat e realizuara nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i kanë qenë 517,264.19 €. Ne në mënyrë të vazhdueshme kërkuam nga ministritë përgjegjëse që diferenca ndërmjet koston direkte dhe pagesave të qasjes në rrjet të paguhet përmes subvencionimit, mirëpo për fat të keq nga Buxheti i Kosovës kishim të ndara vetëm 600,000.00 €, si dhe duke ia shtuar edhe vlerën prej 399,998.87 € në fund të vitit, kështu që subvencionimi i tërë për vitin 2019 arrin vlerën prej 999,998.87 €. Mirëpo përkundër kësaj shtese akoma ka mbetur e pambuluar diferenca e koston direkte në vlerën prej 2,135,001.13 €. Kjo na solli në një situatë tejet të vështirë financiare duke e përkeqësuar edhe më tepër gjendjen financiare të kompanisë.

*Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it mendon që qasja e institucioneve shtetërore ndaj kësaj kompanie duhet të ndryshojë tërësisht, duke e mbështetur këtë kompani ashtu siç e parasheh Ligji mbi Hekurudhat Nr. 04 / L-063 ku parashihet nënshkrimi i kontratës pesëvjeçare financiare me ç'rast njëherë e përgjithmonë do të zgjidhet çështja e financimit të INFRAKOS-it.*

## **Kreditë**

Në vitin 2019 ka vazhduar realizimi i projektit të Linjës së 10 Hekurudhore i cili siç dihet financohet nga BERZH-i dhe BEI-ja përmes kredive të kontraktuara në fund të vitit 2015 dhe grantet e BE-së. Projekti i rehabilitimit gjeneral të linjës së 10 hekurudhore është i paraparë dhe do të realizohet në tri faza:

Faza 1: Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë;

Faza 2; Fushë Kosovë – Mitrovicë; dhe

Faza 3: Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë

Është me rëndësi të ceket se kreditë e marra nga BERZH-i dhe BEI-ja janë kredi të kthimit afatgjatë (për të cilat garant është Qeveria e Republikës së Kosovës), ndërsa kamata kthyese është tepër e vogël. Vlen të ceket se gjysma e vlerës së investimeve për këtë projekt madhor jepet në formë të granteve nga fondet e BE-së përmes mekanizmit të WBIF-it.

## **Projektet kapitale**

Ngjashëm me subvencionimin e kompanisë, për fat të keq edhe financimi i projekteve kapitale nga Buxheti i Kosovës për vitin 2019 ka qenë shumë i vogël, duke u reduktuar në masë tepër të madhe shuma e ndarë në krahasim me vitet e kaluara..

Prandaj, për vitin 2019 përkundër kërkesave tona minimale për buxhetin e projekteve kapitale, Buxheti i Kosovës i ka ndarë vetëm 800,000.00 € për realizimin e projekteve kapitale të kompanisë, ndërsa 650,000.00 € janë ndarë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për sigurimin e tri vendkalimeve elektrike në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë.

Kërkesa e Bordit të Drejtorëve ndaj menaxhmentit ka qenë që realizimi i këtyre projekteve shumë të nevojshme për INFRAKOS-in të realizohet në tërësi dhe duke iu përmbajtur procedurave ligjore në fuqi. Sikurse edhe në vitin paraprak edhe gjatë vitit 2019 Menaxhmenti i INFRAKOS-it i ka kushtuar një vëmendje të veçantë realizimit të projekteve kapitale të cilat janë realizuar në tërësi sipas planit dhe dinamikës së paraparë.

Vlen të përmendet se financimi i projekteve kapitale nga buxheti i shtetit (edhe pse në vlera të vogla) është i domosdoshëm, sepse përmes këtyre projekteve mundësohet mirëmbajtja elementare e infrastrukturës ashtu që kjo infrastrukturë të jetë në gjendje të rregullt dhe të mundësojë qarkullimin e sigurt të trenave.

## **Pagesat e dividendës**

Përkundër dëshirës tonë që INFRAKOS të jetë një kompani fitimprurëse, për fat të keq për shkak të rrethanave ekzistuese kjo ishte e pamundur. Andaj për shkak të gjendjes jo të mirë financiare, INFRAKOS-i nuk i ka paguar aksionarit ndonjë dividendë për vitin 2019. Për më tepër, për shkak të gjendjes të keqe financiare

*INFRAKOS-i nuk ka qenë në gjendje që t'i kryej të obligimet tatimore nda shtetit. Mirëpo obligimet e mbetura të TVSH-së deri në muajin mars 2018 janë kryer nga MZHE-ja, për çka ne kemi një falënderim të veçantë.*

### **Të dhënat për drejtorët jo ekzekutiv**

*Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it deri më datën 02.04.2019 ka pasur këtë përbërje:*

1	Z. Enver Aruqaj,	Kryesues i BD;
2	Z. Nijazi Selmani,	Anëtar i BD;
3	Zj. Fëllënëza Xhelili,	Anëtare e BD
4	Z. Milazim Bytyçi	Anëtar i BD

Me vendimin e Qeverisë nr. 02/96 të datës 02.04.2019 është bërë emërimi i bordit të ri të drejtorëve në përbërjen vijuese:

1	Z. Enver Aruqaj,	Kryesues i BD
2	Z. Lundrim Camaj	Anëtar i BD
3	Z. Enis Berisha	Anëtar i BD
4	Z. Shkëlqim Osmanaj	Anëtar i BD
5	Z. Nagip Skënderi	Anëtar i BD
6	Z. Arben Dodaj	Anëtar i BD

### **Takimet e bordit**

*Bordi i Drejtorëve i Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS gjatë vitit 2019 ka mbajtur takimet e rregullta në mënyrë që të përcjell punën e kompanisë dhe të merr vendimet e nevojshme për performancën e saj. Gjatë vitit 2019 Bordi i Drejtorëve i cili ka punuar deri më datën 02.04.2019 ka mbajtur 3 (tri) takime ndërsa Bordi i ri i Drejtorëve i ka mbajtur 9 (nëntë) takime në të cilat janë trajtuar të gjitha çështjet relevante të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe funksionimin normal të kompanisë.*

*Në të gjitha takimet e mbajtura gjatë vitit 2019, Bordi i Drejtorëve ka analizuar me kujdes të madh raportet e menaxhmentit dhe në veçanti gjendjen e sigurisë dhe atë financiare dhe gjithnjë ka marrë vendimet e duhura në mënyrë që INFRAKOS-i të operojë pa problem. S'do mend se sfida kryesore ka qenë gjendja e vështirë financiare në të cilën ka qenë kompania e për të cilën Bordi në bashkëpunim me menaxhmentin kanë pasur angazhime të përhershme se si të dilet nga kjo situatë e pa lakmueshme. Kuptohet se karshi kësaj gjendjeje janë marrë edhe vendimet adekuate për tejkalimin e saj, por njëkohësisht janë bërë edhe kërkesat drejt institucioneve qeveritare për mbështetjen e kompanisë me subvencionin merititor. Bordi në mënyrë permanente ka bërë analizat e gjendjes së infrastrukturës hekurudhore me theks të veçantë në aspektin e sigurisë, duke sugjeruar dhe duke kërkuar angazhime maksimale për mirëmbajtje të rregullt dhe intervenime të nevojshme për ngritjen e sigurisë të kësaj infrastrukture.*

Në takimet e bordit janë analizuar, diskutuar dhe miratuar të gjitha dokumentet strategjike të kompanisë, përfshirë këtu: planet e biznesit, raportet kuartale, gjashtë mujore dhe vjetore, raportet e kënaqshmërisë së klientëve, pasqyrat financiare, raportet e auditimit, e shumë e shumë çështje tjera në interes të kompanisë.

### **Komitetet e bordit**

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, statutit të kompanisë dhe rregulloreve tjera përkatëse, gjatë vitit 2019 INFRAKOS-i ka pasur të themeluar vetëm komitetin e auditimit. Përbërja e këtij komiteti ka qenë si në tabelën vijuese:

<b>Nr.</b>	<b>Emri i anëtarëve</b>	<b>Pozita</b>
1	Fëllënëza Xhelili	Kryesuese
2	Nijazi Selmani	Anëtar

Pas emërimit të Bordit të ri të Drejtorëve janë themeluar dy komitete të bordit: Komiteti i Auditimit dhe Komiteti për Staf dhe Shpërblime. Komiteti i auditimit ka qenë në përbërjen vijuese:

<b>Nr.</b>	<b>Emri i anëtarëve</b>	<b>Pozita</b>
1	Nagip Skënderi	Kryesues
2	Enis Berisha	Anëtar
3	Arben Dodaj	Anëtar

Ndërsa, Komiteti për Staf dhe Shpërblime ka këtë përbërje:

<b>Nr.</b>	<b>Emri i anëtarëve</b>	<b>Pozita</b>
1	Enis Berisha	Kryesues
2	Arben Dodaj	Anëtar
3	Agron Thaçi	Anëtar

Vlen të përmendet këtu edhe angazhimi maksimal i të gjithë anëtarëve të komitetit të Auditimit të cilët kanë punuar shumë në drejtim të mbarëvajtjes së punëve të kompanisë. Gjatë vitit 2019 Komiteti për auditim i cili ka punuar deri më datën 02.04.2019 i ka mbajtur 3 (tri) takime, komiteti i ri i Auditimit i ka mbajtur 8 (tetë) takime, ndërsa Komiteti për staf dhe shpërblime i ka mbajtur 3 (tri) takime, në të cilat janë trajtuar të gjitha çështjet nën kompetencën e këtyre komiteteve.

### **Informacione tjera**

Viti 2019 një vit i vështirë, por edhe një vit në të cilin janë bërë punë të shumta si në aspektin e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore e po ashtu edhe në fillimin e realizimit të projektit të modernizimit të infrastrukturës hekurudhore. Në të njëjtën kohë gjatë këtij viti është realizuar edhe një projekt tepër i rëndësishëm lidhur me Përcaktimin e pagesave të qasjes në binarë dhe planin e menaxhimit të aseteve. Angazhimet e bordit kanë qenë të mëdha në përkrahjen e këtyre zhvillimeve pozitive

*dhe ne si bord do të vazhdojmë me intensitet të shtuar të përkrahim dhe mbështesim të gjitha projektet zhvillimore të infrastrukturës hekurudhore.*

*Gjatë vitit 2019, Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it ka pasur angazhime të përhershme në ruajtjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, ashtu që të kemi një nivel të lartë të sigurisë, duke ofruar shërbimet e kërkuara nga shfrytëzuesit e kësaj infrastrukture. Ne me kënaqësinë më të madhe mund të konstatojmë se gjatë tërë vitit 2019 nuk kemi pasur asnjë aksident hekurudhor për fajin e INFRAKOS-it. Kjo për ne është një shenjë e suksesit të lartë dhe një shenjë se këtu është punuar me përkushtimin më të madh.*

*Një punë tejet e rëndësishme është bërë edhe në menaxhimin e pronës hekurudhore nga e cila kemi të hyrat e dyta më të rëndësishme të kompanisë. Bordi i Drejtorëve ka diskutuar rregullisht çështjen e pronës duke kërkuar nga menaxhmenti angazhimin maksimal dhe duke e përkrahur atë në të gjithë hapat e ndërmarrë për ruajtjen e pronës dhe eliminimin e dëmtimeve të infrastrukturës hekurudhore. Këtu vlen të përmendet aksioni i cili është ndërmarrë me komunën e Prizrenit për rrënimin e objekteve pa leje të ndërtuara në pronën e hekurudhës.*

*Bordi i Drejtorëve gjatë tërë kohës ka bërë mbështetjen e menaxhmentit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, duke analizuar dhe marrë vendim meritore për secilën kërkesë të drejtuar në emër të Bordit të Drejtorëve. Qëndrimi i jonë tejet korrekt dhe zbatimi me përkushtim i legjislacionit në fuqi, e sidomos zbatimi i statutit të kompanisë, ka ndikuar që gjatë tërë vitit të mos kemi as më të voglin problem, andaj kjo ka rezultuar me një performancë të kënaqshme, gjithnjë duke mos llogaritur kërkesën tonë të pa realizuar për subvencionim nga qeveria.*

*Bordi i Drejtorëve po ashtu ka qenë aktiv në mbajtjen e takimeve të parapara sipas legjislacionit në fuqi, duke dhënë kështu kontributin maksimal për interesin e kompanisë. Në të gjitha takimet tona është trajtuar me shumë kujdes gjendja e kompanisë, situata e tërësishme e saj dhe janë propozuar hapat të cilët duhet të ndërmerren për tejkalimin e situatave të ndryshme.*

*Angazhimet e vazhdueshme të bordit kanë qenë edhe si motiv për stafin menaxhues të kompanisë për realizimin e detyrave të përcaktuara me planin e biznesit. Mirëpo, përkundër rezultateve të mira ne nuk mund të themi se gjithçka është bërë sa edhe si duhet. Për çdo punë dhe veprim mund të diskutohet dhe analizohet gjatë, andaj edhe veprimet tona gjatë vitit 2019 mund t'i nënshtrohen vlerësimeve përkatëse. Mirëpo ne gjithnjë kemi qenë të angazhuar dhe angazhohemi që çdo gjë ta analizojmë me kujdes, të marrim edhe opinionet e të tjerëve në mënyrë që vendimet tona të jenë sa më të drejta.*

## **E ardhmja**

*Për fat të keq, viti 2019 ngjashëm me vitin 2018 ishte vit i mbijetesës sepse për shkak të mos-subvencionimit të kërkuar që nga viti 2013 e deri më sot, INFRAKOS-i ka përjetuar një situatë tejet të vështirë financiare. Ne do të donim shumë dhe duam të shpresojmë që qasja e institucioneve tona përgjegjëse do të ndryshojë dukshëm në vitin 2020. Mos-ndryshimi i qasjes së institucioneve tona ndaj INFRAKOS-it*

edhe në vitin 2020, do të ishte i pa presedan dhe shumë e dëmshme për sistemin hekurudhor në tërësi. Funksonimi i kësaj kompanie në të ardhmen do të varet shumë nga qasja e qeverisë drejt këtij sektori jetik për zhvillimin ekonomik të vendit. Ndikim të madh do të kenë edhe zhvillimet të cilat pritet të ndodhin në vitin 2020, e sidomos vazhdimi i rehabilitimit gjeneral të segmentit të parë dhe fillimi i rehabilitimit të segmentit të dytë të Linjës së 10 Hekurudhore, me ç'rast do të vërehet një ndryshim i madh dhe një lëvizje pozitive e cila do të ketë ndikim edhe tek qytetarët e Kosovës, por edhe tek institucionet e vendit për përkrahjen meritorë të hekurudhës.

Ne jemi të vetëdijshëm se investimi në sektorin hekurudhor kërkon mjete të mëdha dhe se kthimi i këtyre investimeve është i ngadaltë. Por në të njëjtën kohë ne e dimë se një shtet i cili nuk e ka të zhvilluar sektorin hekurudhor, nuk ka bazën themelore të zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye ne po punojmë pa ndarë dhe do të kërkojmë përshtur që obligimi ligjor i qeveris për nënshkrimin e kontratës financiare pesëvjeçare me INFRAKOS-in të realizohet brenda pjesës së parë të vitit. Pra, kërkesat tona kanë qenë dhe mbesin të tilla që ministrinë përkatëse të gjejnë modelin e financimit afatgjatë për Infrastrukturën Hekurudhore, sepse pa këtë financim INFRAKOS-i nuk do të mund të funksionojë.

Përveç angazhimeve në rehabilitimin dhe modernizimin e linjave kryesore hekurudhore, ne do të punojmë jashtëzakonisht shumë edhe në mirëmbajtjen e linjave ekzistuese në funksion të plotë ashtu që të mos cenohet asnjëherë siguria e qarkullimit të trenave. Ne do të bëjmë çmos që në vitin 2020 të bëjmë edhe rihapjen e linjës hekurudhore veriore Mitrovicë – Leshak. Kjo do të jetë një punë e vështirë dhe një situatë e cila kërkon zgjidhje politike, por ne si kompani jemi të gatshëm që të japim gjithë kontributin tonë maksimal për gjetjen e një zgjidhjeje e cila do të jetë në interes të INFRAKOS-it.

Ne jemi të bindur se pa një rrjet hekurudhor modern i cili i plotëson kërkesat e interoperabilitetit nuk do të ketë integrim në rrjetin e hekurudhave rajonale dhe aq më pak në Rrjetin e Integruar të Hekurudhave të BE-së. Prandaj, fillimi i modernizimit dhe më pastaj vazhdimi i modernizimit të tërë Rrjetit Hekurudhor të Kosovës, është kusht i domosdoshëm që ne të jemi pjesë e rrjetit të Integruar të BE-së. Ne jemi të përgatitur që në çdo kohë dhe në çdo moment të ofrojmë siguri të lartë dhe t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e operatorëve hekurudhor të transportit, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. INFRAKOS-i është i gatshëm dhe e mirëpret hapjen e tregut hekurudhor për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor, sepse vetëm me një hapje të tregut të transportit dhe konkurrencë të mirëfilltë mund të ecet përpara.

Përfundimisht, viti 2019 ka qenë viti i sfidave dhe nismave të mëdha, ndërsa viti 2020 do të jetë viti i zhvillimeve të mëdha në infrastrukturën hekurudhore, kështu që me bindje të thellë mund të konstatojmë se INFRAKOS-in po e pret një e ardhme më e mirë e cila e ardhme është e lidhur edhe me të ardhmen më të mirë të vendit. Mirëpo që vizioni ynë të realizohet me sukses, ne presim mbështetjen financiare të shtetit e cila deri më tani ka munguar.

# 3

## ***Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv të INFRAKOS-it***

---

<i>Përshkrimi i përmbajtjes</i>	19
<i>Ngjarjet kryesore të vitit</i>	21
<i>Performanca operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës</i>	27
<i>Pasqyrat e performancës financiare dhe rezultatet</i>	65
<i>Progresi me planin e biznesit</i>	72
<i>Shpenzimet kapitale dhe projektet</i>	77
<i>Perspektive për vitin e ardhshëm</i>	80
<i>Rreziqet e së ardhmes</i>	83

---

## Përshkrimi i përmbajtjes

Raporti vjetor për vitin 2019 është bazuar në kornizën e Udhëzuesit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik mbi përpilimin e raporteve vjetore. Ne kemi tentuar që në mënyrë të detajuar të përshkruajmë gjendjen e kompanisë duke iu përmbajtur pikave të udhëzuesit si në vijim:



Duke iu përmbajtur udhëzuesit në fjalë në vazhdim të këtij raporti janë trajtuar në kapituj të veçantë të gjitha pikat e lartshënuara. Është tentuar që ky raport të jetë sa më i shkurtër, konciz dhe i njëjti lexuesit t'i ofrojë të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që të krijohet një opinion i drejtë mbi ecurinë e INFRAKOS-it në vitin 2019.

Në kapitullin mbi ngjarjet kryesore të vitit janë përshkruar ngjarjet kryesore të cilat kanë ndodhur në kompani gjatë vitit 2019 dhe të cilat janë me interes për aksionarin dhe publikun. Është tentuar që të jepet një informatë e plotë për ngjarjet kryesore të cilat kanë ndodhur në vitin 2019, duke i analizuar ato kryesoret, por duke mos u ndalur në ngjarjet më të vogla të cilat nuk kanë pasur ndonjë ndikim të madh në kompani. Sidoqoftë, përshkrimi i ngjarjeve kryesore të vitit paraqet edhe mënyrën dhe rrugën të cilën INFRAKOS-i e ka zgjedhur për realizimin e objektivave të përcaktuara me planin e biznesit për vitin 2019.

Në kapitullin mbi performancën operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës janë përshkruar të arriturat e secilit departament të kompanisë duke i paraqitur edhe rezultatet apo dështimet eventuale të departamenteve përkatëse, gjithnjë duke i krahasuar ato me planet e veprimt të bazuara në Planin e Biznesit

për vitin 2019. Rëndësi më e madhe i është kushtuar departamenteve ekzekutiv të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe eksploatimin e infrastrukturës hekurudhore, por nuk janë lënë fare anash as departamentet tjera mbështetëse.

Në kapitullin mbi pasqyrat e performancës financiare dhe rezultatet, janë prezantuar të hyrat dhe shpenzimet e realizuara të kompanisë, duke i krahasuar ato me Planin e Biznesit për vitin 2019 dhe vitin paraprak 2018. Në këtë kapitull janë prezantuar në mënyrë të detajuar të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e kompanisë duke bërë sqarimet e duhura për secilin zë buxhetor.

Në kapitullin mbi progresin me planin e biznesit janë prezantuar të arriturat, respektivisht realizimi i detyrave sipas Planit të Biznesit për vitin 2019. Kur kihet parasysh se INFRAKOS-i ka pasur një plan të mirë dhe gjithëpërfshirës të biznesit, atëherë në këtë kapitull është bërë krahasimi ndërmjet objektivave të parapara dhe realizimi i këtyre objektivave.

Në kapitullin mbi shpenzimet kapitale dhe projektet është bërë pasqyrimi detaj i projekteve kapitale të financuara nga buxheti i shtetit dhe projekteve (furnizimeve) tjera të realizuara nga buxheti i kompanisë. në këtë kapitull është përshkruar në mënyrë të detajuar informacioni për secilin projekt të INFRAKOS-it të realizuar në vitin 2019

Në kapitullin mbi perspektiven për vitin e ardhshëm është bërë paraqitja e ideve, objektivave dhe planeve vepruese, apo më mirë të themi vizionit për vitin vijues, duke përshkruar se cilat janë mundësitë, por po ashtu edhe cilat janë sfidat të cilat e presin INFRAKOS-in gjatë vitit 2020.

Në kapitullin mbi rreziqet e së ardhmes është prezantuar SWOT analiza e kompanisë, duke i analizuar përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet të cilat mund ta përcjellin INFRAKOS-in edhe gjatë vitit 2020. Në këtë kapitull është bërë përshkrimi i SWOT analizës duke qartësuar se cilat mund të jenë rreziqet të cilat e presin INFRAKOS-in në të ardhmen, cilat janë mundësitë, mangësitë dhe cila është fuqia e kësaj kompanie.

# 4

## ***Ngjarjet kryesore të vitit***

---

<i>Ngjarjet kryesore të vitit</i>	22
<i>Arritjet kryesore gjatë vitit 2019</i>	23
<i>Çështjet kyçe të trajtuara në vitin 2019</i>	24

---

## Ngjarjet kryesore të vitit

Përkundër problemeve të vijueshme financiare, gjatë vitit 2019 ka pasur zhvillime të mëdha për Sistemin Hekurudhor të Kosovës, respektivisht për Menaxherin e Infrastrukturës – INFRAKOS. Arritjet tona kanë qenë mbresëlënëse, andaj për hir të informimit të drejtë, në vijim janë paraqitur ngjarjet më të rëndësishme të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2019.

**Investimet në modernizim** - Viti 2019 ishte viti i cili karakterizohet me vazhdimin e investimeve të shumëpritura në modernizimin e infrastrukturës hekurudhore. Gjatë këtij viti ka filluar të bëhet rehabilitimi i fazës së parë (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) i linjës së 10 hekurudhore.

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar projekt dizajnit detaj teknik për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë) i linjës së 10 hekurudhore. Pas përfundimit të projekt dizajnit ka filluar edhe procedura e përzgjedhjes së kompanisë e cila do të bënë rehabilitimin e fazës së dytë.

Gjatë këtij viti kemi filluar projekt dizajnin preliminar për rehabilitimin e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Podujevë dhe deri në përfundimin e kuartalit të parë të vitit 2020 pritet të realizohet ky projekt dizajn i cili është bazë për investimet në të ardhmen e afërt.

Gjatë vitit 2019 ne po ashtu kemi filluar studimin e fizibilitetit për linjën hekurudhore Prishtinë - Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës dhe deri në përfundimin e kuartalit të parë të vitit 2020 pritet të realizohet ky projekt i rëndësishëm për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

**Trajnimet** - Një ngjarje tjetër e rëndësishme ndërlidhet edhe me realizimin e projektit mbi Pagesat e Qasjes në Binarë dhe Planin e Menaxhimit të Aseteve, projekt ky i financuar nga grantet e BERZH-it. Ky projekt i rëndësishëm së veçantë është kryer me sukses dhe pritet sigurimi i mjeteve financiare për blerjen e softuerit të ri për zbatimin e këtij projekti.

**Komuniteti i Transportit** – Gjatë vitit 2019 INFRAKOS-i ka bërë një punë tejet të rëndësishme në realizimin e projektit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor – në kuadër të Komitetit Teknik mbi Hekurudhat (TCR) përmes të cilit projekt është paraparë hartimi i legjislacionit konform standardeve të BE-së si dhe plotësimi i kriterëve për tjera teknike për hapjen e tregut hekurudhor. Në kuadër të këtij projekti INFRAKOS-i ka punuar në mënyrë kontinuele për dhënien e informatave dhe realizimin e detyrave të parapara, kështu që me kënaqësinë më të madhe mund të konstatojmë se janë realizuar me shumë sukses të gjitha detyrat e parapara.

**MSA** – Një punë tejet e madhe gjatë vitit 2019 është bërë edhe në realizimin e detyrave të përcaktuara paraprakisht lidhur me Mekanizmin Përcjellës të Stabilizimit Asocimit. INFRAKOS ka qenë njëra ndër kompanitë e cila çdoherë ka dhënë informatat e nevojshme dhe i ka plotësuar të gjitha kërkesat e institucioneve tona qeveritare lidhur me këtë çështje. Pra, të gjitha kërkesat të cilat janë ndërlidhur me përgjegjësitë e INFRAKOS-it janë realizuar në tërësi.

## Arritjet kryesore gjatë vitit 2019

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, në vitin 2019 ka pasur një numër të konsideruar të arritjeve të rëndësishme, duke e zbatuar kështu me përkushtim planin e biznesit për vitin 2019, respektivisht planin e veprimit sipas këtij plani të biznesit. Sfidat kanë qenë të mëdha, mirëpo falë angazhimeve tona të përhershme është arritur që të kemi një sukses të mirë gjatë realizimit të detyrave tona.

INFRAKOS-i ka pasur shumë arritje në vitin 2019 por ne këtu do të përmendim disa prej tyre të cilat ne i konsiderojmë si më të rëndësishmet:

- Realizimi i suksesshëm i projektit të rehabilitimit të linjës së 10 hekurudhore
- Ruajtja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë për të gjitha linjat hekurudhore të cilat për momentin janë në operim;
- Realizimin e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës;
- Rregullimi i sektorit të patundshmërisë;
- Përtëritja e stafit dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore konform mundësive financiare dhe planeve të veprimit; dhe
- Zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

**Rehabilitimi i linjës së 10 hekurudhore** – Njëra ndër arritjet kryesore gjatë vitit 2019 ndërlidhet me vazhdimin e punëve në projektin madhorë të rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës së 10 hekurudhore. Është hera e parë pas shumë e shumë vitesh që ka filluar një projekt kaq i madh infrastrukturorë i përkrahur dhe mbështetur nga institucionet e BE-së. Ne presim që ky projekt të realizohet me sukses edhe gjatë vitit vijues.

**Ruajtja dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë** – Njëra ndër arritjet kryesore gjatë vitit 2019 ndërlidhet me mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore në nivelin e kërkuar, ashtu që komunikacioni hekurudhor i udhëtarëve dhe ai i mallrave të zhvillohet në sigurinë më të lartë të mundshme. Falë angazhimeve maksimale të departamenteve të mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, veprimtarisë elektroteknike dhe atij të komunikacionit, kemi arritur që gjatë vitit 2019 të mos kemi asnjë aksident të komunikacionit hekurudhor i cili ka ndodhur për shkak të infrastrukturës. Kjo ishte një sfidë tejet e madhe të cilën INFRAKOS-i e ka tejkaluar me shumë sukses.

**Realizimin e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës** – Edhe pse me një buxhet të vogël të ndarë nga shteti për realizimin e projekteve kapitale, ne kemi punuar pa ndërprerë në mënyrë që të gjitha projektet e parapara të realizohen sipas planifikimit vjetor. Realizimi i të gjitha projekteve të parapara është bërë në tërësi, gjë që ka ndikuar shumë në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

**Rregullimi i sektorit të patundshmërisë** – Duke ditur se njëra ndër të hyrat më të rëndësishme të INFRAKOS-it krijohet nga patundshmëria, ne gjatë vitit 2019 kemi ndërmarrë një aktivitet tjetër shumë të madh për rregullimin e procedurave në sektorin e patundshmërisë, kujdesin më të madh për pronën e sidomos angazhimin për mbledhjen e borxheve të mbetura. Një punë tepër e madhe është bërë edhe në

mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore, ku vlen të përmendet shembulli i bashkëpunimit me komunën e Prizrenit në rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje në pronën hekurudhore.

**Përtëritja e stafit dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore** – Duke marrë parasysh moshën e vjetërsisë mesatare të punonjësve të INFRAKOS-it tepër të lartë, në karshi kushteve financiare kemi bërë edhe përtëritjen e stafit, e sidomos në zëvendësimin e personave të pensionuar. Politikat tona kanë qenë dhe mbështetja në tilla që të bëhet edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore, prandaj në këtë drejtim është arritur që të realizohet projekti mbi Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe përcaktimin e Pagesave të Qasjes në Rrjet.

**Bashkëpunimi me institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare** – Njëra ndër të arriturat shumë të rëndësishme është edhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet e ndryshme. Në gjatë vitit 2019 kemi zhvilluar një bashkëpunim shumë të madh me të gjitha komunat ku graviton hekurudha në drejtim të ruajtjes së sistemit hekurudhor, si dhe kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer edhe me institucionet tjera vendore.

Sa i përket bashkëpunimeve rajonale, këtu do të përmendim bashkëpunimin me Hekurudhat Maqedonase përmes të cilave kryhet i gjithë transporti hekurudhor. Vlen të përmendim se bashkëpunimi i shkëlqyer me Hekurudhat Maqedonase do të vijojë edhe gjatë vitit 2020.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar vlen të përmendet se ne kemi punuar në mënyrë kontinuale me të gjithë akterët ndërkombëtarë të interesuar për zhvillimin e sektorit hekurudhor, duke filluar nga takimet me institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH, BEI, etj), e deri tek institucionet vendim marrëse siç janë: Komuniteti Evropian Hekurudhor (CER), Komisioni Evropian (EC), Observatori i Transportit për Evropën Jug Lindore (SEETO), e kështu me radhë.

Logjika e jonë ka qenë dhe mbetet që ne duhet të punojmë shumë në sferën e bashkëpunimit me të gjitha institucionet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të sektorit hekurudhor.

## **Çështjet kyçe të trajtuara gjatë vitit 2019**

Dinamika e punëve për të cilat është përgjegjës INFRAKOS-i e kapë një fushë të madhe dhe ndërlidhet me veprimtari të ndryshme. Analizat tona të shpeshta dhe të rregullta nuk kanë lejuar që të bëhen gabime eventuale të cilat do të kishin një kosto të pa paraparë. Trajtimi i të gjitha çështjeve të cilat ndërlidhen me funksionimin normal të INFRAKOS-it është bërë me kujdesin më të madh. Ka shumë çështje të cilat në mënyrë permanente i kemi trajtuar gjatë tërë vitit, por ne do t'i përmendim disa prej tyre:

- ➔ Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit;
- ➔ Gjendja financiare e kompanisë;
- ➔ Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit 2020;
- ➔ Hartimi i marrëveshjes financiare Qeveri – INFRAKOS; dhe

→ Hartimi i Planit të Biznesit për vitin 2020.

**Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit** – Zbatimi i detyrave ditore dhe planeve të veprimit është tema e cila gjatë vitit 2019 është trajtuar më së shumti. Përcjellja e secilit sektor dhe departament është bërë përmes raporteve javore, mujore, kuartale dhe gjashtëmujore duke diskutuar dhe trajtuar çështjet më të ndjeshme, problemet dhe sfidat që i ka pasur ekzekutivi. Në kuadër të kësaj aty ku ka qenë e mundur është vepruar menjëherë duke evituar mangësitë eventuale dhe duke përmirësuar veprimet tona.

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, shpeshherë kemi ardhur në situatë që të mos kemi mundësi të realizojmë blerjen e pjesëve rezervë dhe atyre të domosdoshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore. Mirëpo, falë angazhimeve tona dhe mirëkuptimit nga ana e ekzekutivit, është arritur që të përfundojmë me sukses evitimin e secilës pengesë në procesin e punës.

**Gjendja financiare e kompanisë** – Një punë e madhe është bërë edhe në trajtimin e pasqyrave financiare ashtu që kompania të mund të funksionojë me sukses dhe pa problem. Gjendja financiare e kompanisë është përcjellë në mënyrë të vazhdueshme, kështu që bazuar në këtë gjendje janë marrë edhe vendimet strategjike rreth veprimeve të caktuara. Po e ripërsërisim për të satën herë se gjendja financiare e kompanisë gjatë vitit 2019 ka qenë tepër, tepër e vështirë dhe kjo tanimë është e ditur pa fajin e INFRAKOS-it,

**Hartimi i Ekspozeu i Rrjetit 2020** – Një çështje kyçe e cila ndërlihet me funksionimin normal të kompanisë dhe ndërlihet me krijimin e të hyrave kryesore është Ekspozeu i Rrjetit. Për fat të keq edhe këtë vit ka vazhduar avazi i vjetër me TRAINKOS-in, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ku përkundër shpjegimeve tona dhe hartimit të ER 2020 sipas modeleve të BE-së, me pretekstin se tarifat janë të larta, ky ekspoze nuk është miratuar, por është miratuar Ekspozeu i Rrjetit i njëjtë me atë të vitit 2019.

**Hartimi i Marrëveshjes Financiare Qeveri - INFRAKOS** – Ndër çështjet të cilat janë trajtuar në mënyrë permanente gjatë vitit 2019 ka qenë edhe nënshkrimi i marrëveshjes financiare pesëvjeçare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it. Kjo marrëveshje është e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat Nr. 04 / L – 63 dhe përcakton financimin e kompanisë në kohëzgjatje pesëvjeçare, duke përfshirë këtu subvencionimin dhe financimin e projekteve kapitale të INFRAKOS-it. Për fat të keq, përkundër shprehjes së dëshirës nga institucionet përgjegjëse, kjo marrëveshje akoma nuk është nënshkruar dhe nuk kemi ndonjë informatë se kur pritet nënshkrimi i saj. Ne do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm duke kërkuar që brenda vitit 2020 të bëhet nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.

**Hartimi i planit të biznesit për vitin 2020** – Si zakonisht edhe gjatë vitit 2019 INFRAKOS-i e ka trajtuar me kujdes hartimin e planit të biznesit për vitin 2020 i cili është një plan real dhe gjithëpërfshirës. Edhe në këtë plan të biznesit problemi kryesor qëndron në kërkesën tonë për subvencionim e cila sipas praktikave të deritanishme besojmë se do të ketë problem të realizohet. Vlen të përmendet se ky plan i biznesit është hartuar në pajtim me planin afatgjatë të biznesit (2019 – 2025).

Si përfundim mund të themi se angazhimet tona në vitin 2019 kanë qenë të mëdha, çështjet e trajtuara kanë qenë të shumëllojshme dhe të fushave të ndryshme gjithnjë në interes të zhvillimit të kompanisë. Aty ku puna dhe zhvillimi është varur nga ne, angazhimi i jonë nuk ka munguar asnjëherë dhe zbatimi i detyrave ka qenë në nivelin e duhur. Për fat të keq, shumë çështje të ndërlidhura me ekzistencën financiare të kompanisë nuk janë varur dhe nuk varen nga ne. Andaj me keqardhje themi se ka munguar përkrahja e institucioneve përgjegjëse. Ne shpresojmë dhe besojmë se viti 2020 do të jetë vit i kthimit kah hekurudhat dhe zhvillimet e këtij sektori jetik për zhvillimin ekonomik të vendit.

# 5

## ***Performanca operative e INFRAKOS-it***

---

<i>Departamenti i Komunikacionit</i>	<i>28</i>
<i>Departamenti i MLH-së</i>	<i>35</i>
<i>Departamenti i VET-së</i>	<i>42</i>
<i>Zyra për Planifikim dhe Zhvillim</i>	<i>49</i>
<i>Departamenti i Administratës</i>	<i>51</i>
<i>Departamenti për Pronë dhe Standarde</i>	<i>55</i>
<i>Zyra Ligjore</i>	<i>58</i>
<i>Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Marketing, Shkollim, Mbrojtje në Punë dhe IT</i>	<i>60</i>
<i>Kontrollori i Brendshëm</i>	<i>63</i>

---

## Departamenti i Komunikacionit

---

Departamenti i komunikacionit merret me organizimin e qarkullimit të trenave të udhëtarëve, të mallrave, apo edhe me organizimin e qarkullimit të mjeteve tjera lëvizëse hekurudhore. Në vitin 2019 ky departament ka bërë realizimin e të gjitha detyrave të parashtruara, duke filluar nga organizimi i lëvizjes së trenave, ofrimi i shërbimeve tjera për operatorin hekurudhor, realizimin e tërësishëm të orarit të lëvizjes së trenave për vitin 2019, si dhe lejimi dhe realizimin e traseve të veçanta (të jashtëzakonshme) të trenave sipas kërkesave të TRAINKOS-it.

Sikurse të gjitha departamentet tjera, edhe ky departament gjatë vitit 2019 ka qenë i angazhuar maksimalisht që të bëjë organizimin e qarkullimit të trenave në mënyrë të sigurt dhe sipas orarit të lëvizjes.



Një punë e mirë dhe tejet e suksesshme është bërë edhe në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e punës në perioda të ndryshme gjatë ditës, gjatë natës dhe në të gjitha stacionet hekurudhore, ashtu që të verifikohet mbarëvajtja dhe realizimi i rregulloreve të komunikacionit në secilin stacion.

Ky departament po ashtu në baza ditore ka bërë në mënyrë kontinuele përcjelljen e lëvizjes së të gjithë trenave, respektivisht numrin e tyre dhe kilometrat e kaluara, ashtu që më pastaj me përfaqësuesit e TRAINKOS-it është bërë edhe llogaritja e pagesave të qasjes në rrjet për çdo muaj. Llogaritja e pagesave të qasjes në rrjet është bërë duke u bazuar në Ekspozeun e Rrjetit të vitit 2019 dhe Marrëveshjen mbi Qasjen në Rrjet e nënshkruar ndërmjet INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it për vitin në fjalë. Një punë e njëjtë është kryer edhe me operatorin e ri privat RAILTRANS-in.

Një punë tjetër e rëndësishme e këtij departamenti ka qenë edhe ofrimi i shërbimeve të ngarkim shkarkimit të mallrave në Terminalin e Mallrave në Miradi, duke ju ofruar të gjithë klientëve shërbime të mira, korrekte, transparente dhe të menjëhershme. Për fat të keq, numri i kontejnerëve dhe mallrave tjera në vitin 2019 ka qenë tejet i vogël (për të mos thënë se nuk ka pasur fare), gjë që ka rezultuar me një afarizëm jo të kënaqshëm.

Sidoqoftë, me një menaxhim të mirëfilltë dhe angazhim të të gjithë stafit të departamentit të komunikacionit, është bërë edhe përmbushja e objektivave të caktuara me planin e biznesit të vitit 2019. Ndër objektivat të cilat janë të lidhura me këtë departament do t'i numërojmë këto:

- ➔ Sigurinë e komunikacionit hekurudhor për të gjitha llojet e trenave;
- ➔ Ofrimin e shërbime në mënyrë efikase për të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga klientët tanë, siç është TRAINKOS-i, RAILTRANS-i dhe klientët tjerë të terminalit të mallrave;
- ➔ Hartimin me kohë të udhëzimeve për sigurinë e komunikacionit dhe planit të veprimit për sezonin dimërorë;
- ➔ Zbatimin e Ekspozeut të Rrjetit i cili paraqet dokumentin kryesor për realizimin e pagesave nga qasja në rrjetin hekurudhor;
- ➔ Kontrollimin e rregullt të punës së stacioneve dhe evitimin e menjëhershëm të mangësive eventuale;
- ➔ Trajnimin dhe testimin e rregullt të stafit të departamentit; dhe
- ➔ Përmirësimin e ambientit nëpër stacione për udhëtarë.

Pra, gjatë vitit 2019 angazhimi i të gjithë punonjësve të departamentit ka qenë i kënaqshëm, andaj falë këtij angazhimi nuk kemi pasur asnjë ngecje në realizimin e detyrave të parapara dhe mbi të gjitha siguria e komunikacionit hekurudhore ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm.

### **Sektori i rregullimit të komunikacionit**

Sektori i komunikacionit gjatë vitit 2019 ka zhvilluar një aktivitet të madh në organizimin e komunikacionit hekurudhor të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave nëpër tërë rrjetin hekurudhor në funksion duke i përmbushur me sukses të gjitha detyrat e parapara me planin e veprimit të këtij sektori.

Ky sektor gjatë gjithë kohës e ka mbikëqyrë në mënyrë të rreptë zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve për sigurinë e komunikacionit, që si rezultat ka pasur një ngritje të cilësisë dhe kualitetit të ofrimit të shërbimeve.



Ndër detyrat kryesore të realizuara nga ky sektor gjatë vitit 2019 do të përmendim detyrat në vijim:

- ➔ Organizimin e sigurt të lëvizjes së trenave dhe planifikimin e tyre si dhe kontrollimin e zbatimit të dispozitave të sigurisë së komunikacionit;
- ➔ Kontrollimin e rregullshmërisë së lëvizjes së trenave nga ana e dispeçerëve të komunikacionit dhe operatorëve në CTC-së (për ato stacione ku sistemi funksionon);
- ➔ Kontrollimet e zbatueshmërisë së rregulloreve dhe udhëzimeve të punës nëpër të gjitha stacionet hekurudhore;

- ➔ Kontrollimin e rregullt mujor të skambjeve dhe pajisjeve tjera të infrastrukturës së bashku me Departamentin e Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore dhe Departamentin e Elektroteknikës;
- ➔ Realizimin e suksesshëm të qarkullimit për të gjithë trenat e udhëtarëve dhe atyre të mallrave sipas orarit të lëvizjes së trenave;
- ➔ Realizimin e suksesshëm të qarkullimit për të gjithë trenat e udhëtarëve dhe atyre të mallrave sipas kërkesave ad hok të TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it;
- ➔ Organizimin dhe realizimin me përkushtim të të gjitha shërbimeve tjera për operatorët e transportit;
- ➔ Mbikëqyrjen dhe evidentimin e lëvizjes së të gjitha llojeve të trenave;
- ➔ Pastrimin e rregullt të stacioneve hekurudhore dhe binarëve brenda territorit të stacionit;
- ➔ Pastrimin e rregullt të borës dhe akullit nëpër skambje gjatë sezonit dimëror;
- ➔ Udhëheqjen e ekipit të ekspertëve për hulumtimin e rasteve të jashtëzakonshme;
- ➔ Hartimin e planeve operative për sezonin dimëror;
- ➔ Hartimin e dokumenteve teknike për secilin stacion sipas orarit të lëvizjes së trenave për vitin 2019
- ➔ Organizimin e trajnimeve teorike dhe mbajtjen e provimeve për stafin ekzekutiv në bashkëpunim me sektorin e shkollimit;
- ➔ Organizimin praktik të trajnimit për punonjësit e rinj; dhe
- ➔ Punët dhe detyrat tjera të ndryshme sipas nevojave ditore.

Në mënyrë që të kemi një pasqyrim më të mirë të informatave dhe të dhënave rreth aktiviteteve të këtij sektori, në vijim janë prezantuar në formë tabelare të dhënat mbi lëvizjen e trenave dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme të cilat kanë ndodhur në vitin 2019 duke i krahasuar ato me vitin 2018.

Krahasimi i trenave	Trenat e udhëtarëve			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2019	3643	3619	24	31
Viti 2018	3481	3197	284	302
Ndryshimi (2019 - 2018)	162	422	- 260	- 271

Krahasimi i trenave	Trenat e mallrave			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2019	2066	992	1074	762
Viti 2018	1263	600	663	1590
Ndryshimi (2019 - 2018)	803	392	411	- 828

Nga tabelat e mësipërme shihet se numri i trenave të udhëtarëve të cilët kanë qarkulluar në vitin 2019 është për 162 trena më i madh sesa numri i trenave nga viti 2018, ndërsa sa i përket trenave të mallrave, situata është më premtuese, sepse në vitin 2019 ka pasur një rritje të numrit të trenave të mallrave prej 803, gjë që e jep një shpresë se do të ketë një përmirësim të transportit hekurudhor të mallrave në të ardhmen e afërt.

Rastet e jashtëzakonshme	Numri i aksidenteve	Aksidentet në vendkalime	Aksidentet në stacione dhe linjë të hapur	Vlera e dëmeve materiale në €	Auto të dëmtuara	Numri i personave të vdekur	Numri i personave të lënduar
Viti 2019	16	12	4	0.00	10	5	10
Viti 2018	19	15	4	1,490.00	19	3	13
Ndryshimi (2019 - 2018)	- 3	- 3	0	-1,490.00	- 9	2	- 3

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur rastet e jashtëzakonshme, respektivisht aksidentet të cilat kanë ndodhur në hekurudhë gjatë vitit 2019, duke i krahasuar ato me vitin 2018. Nga tabela shihet se numri i aksidenteve në këtë vit është për 3 (tri) aksidente më i vogël se në vitin paraprak. Nga këto 16 (gjashtëmbëdhjetë) aksidente, 12 (dymbëdhjetë) prej tyre kanë ndodhur në vendkalimet e pambrojtura dhe 4 (katër) aksidente në linjë të hapur hekurudhore. Numri i të lënduarve në këto aksidente është 10 (dhjetë), apo për 3 (tre) më i vogël se në vitin 2018. Numri i të vdekurve është 5 (pesë), apo 2 (dy) më i madh sesa në vitin paraprak.

Analizat e komisioneve për hetimin e aksidenteve kanë treguar se shkaktarë të të gjitha aksidenteve janë palët e treta, respektivisht pjesëmarrësit e komunikacionit rrugor (ngasësit e automjeteve të cilët për fatin e keq të tyre nuk i kanë respektuar shenjat e sinjalizimit rrugor në kryqëzimet në nivel rrugë – hekurudhë.


### Shërbimi i qasjes në binarë

Shërbimi i qasjes në binarë e ka realizuar me sukses detyrën e vet të përcaktuar me rregullore duke bërë kështu në baza ditore evidentimin e të gjitha traseve të trenave të udhëtarëve dhe të mallrave të realizuara gjatë vitit 2019. Njëkohësisht ky shërbim ka bërë edhe evidentimin e shërbimeve tjera të cilat INFRAKOS-i ia ka dhënë TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it gjatë operimit. Detyra primare e këtij shërbimi ka qenë që të bënë përcjelljen dhe llogaritjen e pagesave të cilat operatori i transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS duhet t'i kryejnë në emër të pagesave të qasjes në rrjet dhe falë angazhimeve maksimale edhe ky shërbim e ka realizuar me sukses planin e punës në baza ditore dhe mujore.

Për një pasqyrim më të mirë në tabelën e mëposhtme është bërë paraqitja e të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë për trenat e udhëtarëve, ata të mallrave, si dhe shërbimet tjera të cilat INFRAKOS-i ia ka ofruar Operatorit të Transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS. Nga tabela shihet se në vitin 2019 trendi i të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet ka pasur një rritje në krahasim me të hyrat e vitit paraprak. Kjo për ne paraqet një mirë sepse siç është potencuar disa herë këto të hyra paraqesin të hyrat kryesore të kompanisë.


Nga tabela vijuese shihet se në vitin 2019 të hyrat nga trenat e udhëtarëve janë rritur për 26,140.53 € në krahasim me vitin 2018, ndërsa të hyrat nga trenat e mallrave kanë po ashtu një rritje për 65,025.72 €. Sa i përket shërbimeve tjera kemi po ashtu një rritje të të hyrave në vlerën prej 20,424.11 €. Në tërësi, të hyrat totale nga TRAINKOS-i në vitin 2019 janë për 106,717.28 € më të mëdha sesa ato në vitin 2018, gjë që për INFRAKOS-in paraqet një lajm të mirë. Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i këtyre të hyrave, ndërsa në vazhdim edhe paraqitja e tyre grafike.

Të hyrat nga qasja në rrjetin hekurudhor	Trenat e udhëtareve	Trenat e mallrave	Trenat ad hok	Shërbimet tjera	Të hyrat totale
Viti 2019	255,476.13	138,369.94	0.00	93,129.71	486,975.78
Viti 2018	229,335.60	73,344.22	4,873.08	72,705.60	380,258.50
Ndryshimi (2019 – 2018)	26,140.53	65,025.72	-4,873.08	20,424.11	106,717.28



Përveç të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet nga TRAINKOS-i, ne kemi pasur edhe të hyrat e qasjes në rrjet nga operatori privat i transportit të mallrave RAILTRANS. Andaj në vijim është bërë paraqitja tabelare dhe grafike e të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë për trenat e mallrave nga Operatori i Transportit RAILTRANS.

Të hyrat nga qasja në rrjetin hekurudhor	Trenat e mallrave	Trenat ad hok	Shërbimet tjera	Të hyrat totale
Viti 2019	19,474.32	308.83	10,505.26	30,288.41
Viti 2018	14,443.81	1,332.31	7,563.25	23,339.37
Ndryshimi (2019 – 2018)	5,030.51	-1,023.48	2,942.01	6,949.04



Nga tabela e mësipërme shihet se kompania RAILTRANS nuk ka pasur ndonjë rritje të madhe në fushën e transportit hekurudhor të mallrave, gjë që në krahasim me vitin 2018 kemi të hyra vetëm për 6,949.04 € më të mëdha, mirëpo mbetet shpresa që kjo kompani në vitin 2020 të ketë një transport më të madh e që do të ishte në favor edhe të INFRAKOS-it.

### Terminali i mallrave

Terminali i mallrave në Stacionin Hekurudhor në Miradi si i vetmi terminal në sistemin hekurudhor të Kosovës ku bëhet ngarkim shkarkimi i kontejnerëve dhe i mallrave tjera, në vitin 2019 ka realizuar me sukses të gjitha detyrat e parapara. Kur dihet se kapacitetet e këtij terminali janë dukshëm më të mëdha, atëherë del se për shkak të rënies së transportit numri i kontejnerëve ngjashëm me vitin paraprak ka qenë zero dhe po ashtu edhe sasia e mallrave tjera të transportuara përmes këtij terminali ka qenë tepër apo më mirë të themi tmerrësisht e vogël. Sidoqoftë, terminali i mallrave në Miradi është terminal i hapur dhe ofron të gjitha shërbimet e ngarkim shkarkimet të të gjitha llojeve të vagonëve, bënë ngarkim shkarkimin e të gjitha llojeve të kontejnerëve, si dhe ofron shërbimin me piruner për ngarkimin apo shkarkimin e transportit me paleta.

Të hyrat nga Terminali	Numri i kontejnerëve	Të hyrat nga krani	Të hyrat nga piruneri	Të hyrat nga fletëhyrjet	Totali i të hyrave
Viti 2019	0	200.00	8,113.00	6,780.00	15,093.00
Viti 2018	0	1,320.00	11,130.00	8,510.00	20,960.00
Diferenca (2019 – 2018)	0	-1,120.00	- 3,017.00	-1,730.00	- 5,867.00

## **Përfundim**

Angazhimet e tërë stafit të departamentit të komunikacionit si njëri nga departamentet më me rëndësi të INFRAKOS-it, kanë qenë shumë të madha. Qëllimi i këtij departamenti ka qenë që të bëjë realizimin e suksesshëm të orarit të lëvizjes së trenave për vitin 2019, gjë që edhe e ka bërë. Andaj, përkundër sfidave të shumta nëpër të cilat është kaluar, ky departament i ka realizuar me sukses të gjitha detyrat e parashtruara me planin e veprimit të kompanisë, duke zbatuar në tërësi rregulloret ekzistuese mbi organizimin e komunikacionit hekurudhor. Prandaj, për fund mund të konstatojmë me kënaqësi se departamenti i komunikacionit gjatë vitit 2019 ka pasur një performancë të mirë dhe se detyrat e parashtruara i ka kryer me sukses. Ne besojmë që ngjashëm me vitin 2019, departamenti i komunikacionit do të jetë i suksesshëm edhe gjatë vitit 2020.

## Departamenti për Mirëmbajtjen e Linjave Hekurudhore (MLH)

---

Departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore (MLH) gjatë vitit 2019 ka bërë në mënyrë të vazhdueshme mirëmbajtjen e linjave hekurudhore, urave, tuneleve, lëshesave, gjeometrisë së binarit, kanaleve ujë-përcjellëse, bankinave, skambjeve, eliminimin e rrëshqitjeve nga dheu, pastrimin e profilit të lirë, vendkalimeve në nivel dhe shumë e shumë punë dhe detyra tjera në mënyrë që infrastruktura hekurudhore të garanton lëvizjen e sigurt të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave.



Angazhimi i të gjitha shërbimeve ka qenë në koordinim të mirëfilltë, ashtu që të realizohet me sukses plani i veprimit të departamentit duke u mbështetur në planin e biznesit të kompanisë.

Objektivi kryesor i këtij departamenti ka qenë që të bëhet mirëmbajtja e rregullt e infrastrukturës hekurudhore ashtu që të mundësohet qarkullimi i sigurt i trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave. Edhe pse me vështirësi të mëdha për shkak të mungesës së materialit rezervë, prapë se prapë falë shfrytëzimit të kujdesshëm të pjesëve rezervë është arritur që të ruhet niveli i duhur i sigurisë.

Angazhimi i këtij departamenti ka qenë shumë i madh, edhe në kontrollimin e të gjitha linjave hekurudhore, si të atyre të cilat janë në funksion e po ashtu edhe të atyre të cilat janë jashtë funksionit. Përveç mbikëqyrjes së linjave përmes punonjësve të cilët lëvizin në këmbë nëpër binarë duke kontrolluar gjendjen fizike të tyre, në mënyrë permanent është bërë edhe kontrollimi dhe matja e rregullt e të gjithë parametrave të nevojshëm të infrastrukturës hekurudhore, në mënyrë që për çdo mangësi të reagohet menjëherë edhe me njësitin e mekanizimit ku përmes makinave plaser është bërë rregullimi i binarëve. Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe intervenimi me kohë kanë bërë që gjatë tërë vitit 2019 të mos ketë asnjë aksident për shkak të infrastrukturës hekurudhore.

**Rregullimi i gjeometrisë së binarit** – Njëra ndër punët më të rëndësishme të këtij departamenti gjatë vitit 2019 ka qenë rregullimi i gjeometrisë së binarit sipas kahes dhe niveletës me fuqi punëtore dhe makina Plaser. Në vitin 2019 kryesisht është



punuar në ngritjen e rënieve të shkurtra me fuqi punëtore, ndërsa rregullimi i gjeometrisë së binarit sipas kahes dhe niveletës është bërë me makina Plaser nga shërbimi i mekanizimit. Puna e realizuar ka qenë e nivelit të lartë, pasi që këto rregullime të binarëve janë bërë me ndihmën e makinës moderne e cila është e dedikuar për këtë qëllim. Andaj, falë këtyre punëve të realizuara linjat hekurudhore në funksion gjatë tërë vitit kanë mundur një qarkullim shumë të sigurt të trenave.

**Rregullimi i ndërrueseve sipas kahes dhe niveletës** – Një punë shumë e madhe është bërë edhe në mirëmbajtjen e ndërrueseve dhe rregullimin e tyre. Ndër punët më të rëndësishme e cila ndërlihet me sigurinë e qarkullimit të trenave është edhe rregullimi i kahes dhe niveletës nëpër skambje është bërë me fuqi punëtore dhe



makina Plaser. Në periudhën Janar – Dhjetor 2019 është bërë mirëmbajtje e rregullt e skambjeve në të gjitha linjat hekurudhore.

Duke pasur parasysh se skambjet janë njëri ndër mekanizmat kryesor të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në sigurinë e lëvizjes së trenave, ne kemi pasur një angazhim maksimal në mirëmbajtjen e tyre.

**Pastrimi dhe rregullimi i konstruksionit të vendkalimeve** - Në këtë pozicion të punës përfshihet mirëmbajtja, nivelimi dhe pastrimi i vendkalimeve në nivel hekurudhë – rrugë. Këtu është bërë një punë e madhe, sidomos në rregullimin e shiritit kalues të automjeteve në zonën e vendkalimeve. Gjatë këtij viti është bërë rregullimi dhe mirëmbajtja e zonave të këtyre vendkalimeve në drejtim të ngritjes së



kushteve teknike dhe sigurisë për qarkullimin e trenave dhe garantimin e sigurtë të kalimit të automjeteve nëpër këto vendkalime. Një punë e madhe është bërë edhe në pastrimin dhe rregullimin e profilit të lirë dhe këndit të dukshmërisë së të gjitha vendkalimeve, duke ngritur kështu sigurinë e qarkullimit të mjeteve rrugore. Është bërë një punë tepër

e rëndësishme edhe për vendosjen e shenjave të cilat paralajmërojnë mjetet lëvizëse për arritjen në vendkalimet rrugë / hekurudhë.

**Rrënimi i vendkalimeve ilegale –** Njëri ndër problemet kryesore gjatë këtyre viteve ka qenë dhe mbetet ndërtimi i vendkalimeve ilegale nga persona të papërgjegjshëm.



Kjo ka ndodhur edhe gjatë vitit 2019, ndërsa si zakonisht Departamenti i MLH-së për secilin rast ka intervenuar menjëherë duke e bërë rrënimin e këtyre vendkalimeve por në të njëjtën kohë duke e njoftuar Policinë e Kosovës dhe zyrën ligjore për përgatitjen e padive për rastet kur personi i caktuar e ka

përsëritur të njëjtën gjë, duke e hapur prapë vendkalimin.

Sidoqoftë, puna e palodhshme e këtij departamenti për eliminimin e vendkalimeve ilegale ka bërë që ne sot të mos kemi vendkalime të tilla të cilat do ta rrezikonin pa masë komunikacionin hekurudhor.

**Pastrimi i kanaleve dhe lëshesave ujë përcjellëse –** Linjat tona hekurudhore përgjatë tërë gjatësisë së tyre, aty ku mund të ketë vërshim të shtratis hekurudhor për shkak të reshjeve atmosferike apo daljes së lumenjve nga shtrati, janë të mbrojtura nga kanalet anësore dhe lëshesat hekurudhore të cilat si detyrë primare e kanë që të mos e lejojnë futjen e ujit nëpër binarë.



Gjatë këtij viti vazhdimisht është bërë dhe bëhet pastrimi i lëshesave dhe kanaleve ujëpërcjellëse me fuqi punëtore dhe ekskavator të cilat mbulohen gjatë shembjes së dheut dhe prurjeve nga uji. Kjo punë shumë e rëndësishme është kryer me sukses, kështu që linjat tona hekurudhore kanë qenë tërësisht të mbrojtura nga vërshimet eventuale.

**Pastrimi i akullit dhe bores nëpër skambje, vendkalime dhe tunele –** Si zakonisht në muajin janar, shkurt dhe mars të këtij viti gjatë sezonit dimëror si gjithmonë për shkak të reshjeve të borës dhe ngricave është bërë rregullisht pastrimi i borës dhe akullit nëpër skambjet hekurudhore dhe po ashtu është bërë pastrimi i akullit nga tunelet. Pra, njësitë e mirëmbajtjes kanë qenë gjithnjë në gatishmëri duke bërë intervenimet e caktuara varësisht se ku ka qenë nevoja. Kjo ka garantuar zhvillimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor.



**Pastrimi i profilit të lirë dhe tharja e barojave** - Pastrimi i profilit të lirë është bërë në vendet ku pengohet shikueshmëria nga mjetet lëvizëse hekurudhore si dhe ato rrugore ku hekurudha është e kryqëzuar në një nivel me rrugët, në kthesa dhe



vendet ku profili pengon lëvizjen e sigurt të trenave. Gjatë këtij viti dhe në veçanti pas periudhës së gjelbërimit është bërë pastrimi i profilit nëpër të gjitha linjat hekurudhore në operim në mënyrë që të rritet dukshmëria e linjave hekurudhore e

cila është e lidhur ngushtë me sigurinë e komunikacionit dhe qarkullimin e mjeteve lëvizëse.

Një problem shumë i madh për linjat hekurudhore paraqesin barojat e ndryshme të cilat dalin në binarë. Andaj edhe gjatë këtij viti njëra nga detyrat permanente të këtij departamenti ka qenë e ndërlidhur me tharjen e barojave e cila është bërë me vagon cisternë i përshtatur për tharjen e barojave nëpër binarët e stacioneve dhe linjat e hapura hekurudhore. Pra intervenim i është bërë me kohë dhe ka qenë shumë i suksesshëm.

**Saldimi alumino-termik i shinave dhe mirëmbajtja e materialit përforcues të shinave** – Gjatë këtij viti, respektivisht në periudhën korrik - shtator është bërë



saldimi i shinave të dëmtuara, sidomos në zemërat e ndërrueseve të cilat i nënshtrohen më së shumti dëmtimeve për shkak të fërkimit gjatë qarkullimit të trenave. Intervenimet në eliminimin e këtyre pengesave kanë qenë kontinuale edhe jashtë periudhës së përmendur në varësi të dëmtimeve të shfaqura.

Përveç saldimit të shinave, një punë shumë e madhe është bërë edhe në lyerjen e bulonave përforcues të shinave ashtu që të garantohet një efikasitet dhe siguri maksimale e linjave hekurudhore për qarkullimin e trenave.

**Ndërrimi i traversave të vjetruara** – Në mënyrë që të garantohet siguria e qarkullimit të trenave njësitë e mirëmbajtjes së binarëve në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë kontrollimin e linjave hekurudhore dhe pas verifikimeve në teren është



bërë zëvendësi mi i traversave të vjetërsuara me traversa të reja. Kjo paraqet një punë voluminoze të cilën njësitë përkatëse të mirëmbajtjes e kanë kryer me shumë sukses.

Zëvendësi mi i traversave të vjetërsuara varësisht nga nevoja është bërë në linjat e hapura hekurudhore, apo në binarët brenda stacioneve dhe sidomos në ndërruese. Ky veprim ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së linjave hekurudhore duke garantuar sigurinë maksimale të qarkullimit të trenave.

**Ndërrimi i shinave me kokë të konsumuar nëpër kthesa** – njëra ndër punët më të rëndësishme në mirëmbajtjen e linjave hekurudhore ndërlidhet edhe me



zëvendësimin e shinave të cilat kanë qenë të konsumuara për shkak të fërkimit të mjeteve lëvizëse. Zakonisht shinat për shkak të fërkimit konsumohen nëpër kthesa dhe në këtë mënyrë rrezikohet siguria e qarkullimit të trenave.

Njësitë e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore gjatë tërë vitit kanë bërë mbikëqyrjen e shinave dhe varësisht nga dëmtimi është bërë menjëherë zëvendësimi i tyre.

**Kontrollimi dhe mirëmbajtja e binarëve** – Përveç punëve të mirëmbajtjes, gjatë vitit 2019 Departamenti i MLH-së ka kryer në mënyrë të rregullt edhe kontrollimin e binarëve nëpër tërë rrjetin hekurudhor duke evidentuar kështu mangësitë eventuale



dhe duke ndërmarrë të gjitha masat për evitimin e këtyre mangësive. Këto kontrollime janë bërë në baza ditore nga njësitë përkatëse të mirëmbajtjes.

Në mënyrë të njëjtë është bërë edhe kontrollimi i binarëve industrial për mirëmbajtjen e të cilëve INFRAKOS-i ka kontrata vjetore me pronarët e këtyre binarëve.

**Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc –** Gjatë ndërtimit të autostradës Prishtinë – Hani i Elezit në grykën e Kaçanikut është dashur të bëhet rregullimi i shtratit të lumit



ashtu që të mos vjen deri tek vërshimet në linjën hekurudhore. Në bashkëpunim me kompaninë ndërtuese të autostradës është arritur që të rregullohet shtrati i lumit dhe departamenti i MLH-së gjatë tërë kohës ka qenë në mbikëqyrje të realizimit të punëve,

ashtu që të garantohet një siguri afatgjate e mbrojtjes së shtratit hekurudhor nga vërshimet eventuale.

**Ndërtimi i binarit për trenin memorial në Bllacë –** Gjatë muajit prill 2019 sipas kërkesës së institucioneve shtetërore është bërë një punë shumë e rëndësishme për



ndërtimin e binarit për vendosjen e trenit memorial në Bllacë në shenjë të përkujtimit të dëbimit të dhunshëm të popullatës shqiptare nga forcat okupatore serbe në kohën e luftës. Ky binar është kryer në kohë rekorde nga ekspertët dhe punonjësit e Departamentit të MLH-së dhe me mjete të INFRAKOS-it.

**Rehabilitimi i linjës së 10-të hekurudhore –** Gjatë vitit 2019, respektivisht në gusht



të këtij viti ka filluar edhe rehabilitimi gjeneral i fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Departamenti i MLH-së ka qenë aktiv në ofrimin e shërbimeve të veta në mënyrë që ky projekt madhor të realizohet me sukses.

Të vetëdijshëm për rëndësinë e mbrojtjes së Rrjetit Hekurudhor të Kosovës, Departamenti i MLH-së përveç mirëmbajtjes së rregullt dhe asaj investive ka pasur angazhime kontinuale edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e pronës hekurudhore e cila paraqet bazën kryesore tepër të rëndësishme për funksionimin normal dhe zhvillimeve të ardhshme të sistemit hekurudhor të Kosovës. Prandaj synimet tona për një rrjet hekurudhor të mirëfilltë po realizohen me sukses.

Përveç punëve të lartpërmendura, Departamenti i MLH-së ka kryer edhe shumë e shumë punë të rëndësishme në baza ditore, duke realizuar me sukses detyrat e parashtruara me planin e veprimit të kompanisë dhe në veçanti duke bërë intervenime të menjëhershme varësisht se ku është paraqitur nevoja. Ky përkushtim ka ndikuar që linjat hekurudhore të cilat janë në funksion të garantojnë një siguri maksimale për qarkullimin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave.

Është normale se përkundër këtyre angazhimeve gjatë vitit 2019 ky departament ka pasur edhe sfidat e veta të cilat me analiza të mirëfillta dhe një punë të përkushtuar nga i gjithë stafi, janë tejkaluar me sukses. Prandaj performanca e këtij departamenti në vitin 2019 ka qenë shumë e mirë.

## Departamenti i Veprimtarisë Elektroteknike


Departamenti i Veprimtarisë Elektroteknike (VET) në strukturën e vet organizative përmban shërbimet vijuese:

1. Shërbimi i pajisjeve sinjalo-siguroese;
2. Shërbimi i pajisjeve telekomunikuese; dhe
3. Shërbimi i pajisjeve të energjetikës.

Gjatë vitit 2019 secili nga shërbimet e lartcekura i ka realizuar me sukses objektivat e parapara me planin e veprimit të kompanisë duke bërë mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe atyre të energjetikës me synim të rritjes së sigurisë të komunikacionit hekurudhor. Raporti vjetor i këtij departamenti



përmban aktivitetet e punonjësve të cilët gjatë tërë vitit kanë pasur një angazhim të madh në realizimin e planit të veprimit dhe në punët tjera ditore rreth mirëmbajtjes së pajisjeve SS, TK dhe EN.



Bazuar në Planin e Biznesit për vitin 2019, Departamenti i VET-së ka pasur objektivat vijuese:

- Organizimi efektiv në ngritje të sigurisë të komunikacionit hekurudhor;
- Efikasiteti në realizimin e projekteve në departament;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e sistemeve hekurudhore të sigurisë;
- Shkollimi dhe trajnimi i personelit për teknologji të re që aplikohet në shërbimet SS,TK dhe EN;
- Realizimi i investimeve të parapara nga plani i biznesit; dhe
- Realizimi i të hyrave nga qiraja e kabllove optike.

Nga perspektiva e analizave të bëra, ne mund të konstatojmë me kënaqësinë më të madhe se ky departament i ka realizuar me sukses detyrat e parashtruara, duke pasur një angazhim maksimal gjatë tërë vitit.

**Organizimi efektiv në ngritje të sigurisë të komunikacionit hekurudhor** - Në kuadër të kësaj objekteve sektori ka pasur aktivitet në evitim të shpejtë të pengesave duke intervenuar edhe jashtë orarit të punës por kemi raste kur në mungesë të materialit jemi vonuar apo nuk kemi evitua pengesën. Mungesa e materialit për evitim të pengesave është një faktor që e rritë shkallën e rrezikshmërisë apo zvogëlon shkallën e sigurisë së komunikacionit hekurudhor.

**Efikasiteti në realizimin e projekteve në departament** – Departamenti i VET në mënyrë kontinuale i ka realizuar të gjitha detyrimet për përgatitje të listës së projekteve apo edhe të specifikacioneve të nevojshme për realizimin e tyre.

**Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e sistemeve hekurudhore të sigurisë** - Ekipet e ekspertëve tanë kanë punuar në mirëmbajtje të pajisjeve SS,TK dhe EN duke i mbajtur ato me vështirësi në gjendje të mirë funksionale përshaka të mungesës së pjesëve rezervë dhe vjetërsisë së tyre (mbi 30 vite janë sistemet e vjetra). Pasi pritet që sistemet e sinjalizimit të ndërrohen me sisteme elektronike jemi përkufizuar edhe në furnizim me pjesë rezervë.

**Shkollimi dhe trajnimi i personelit për teknologji të re që aplikohet në shërbimet SS,TK dhe EN** - Me qëllim që stafi i jonë të ketë përgatitje sa më profesionale dhe të domosdoshme disa herë është iniciuar propozimi që të bëhet një vizitë në hekurudhat fqinje ku janë duke u realizuar disa projekte në ndërrim të teknologjisë së vjetër me teknologji të re. Për fat të keq në mungesë të mjeteve financiare nuk u realizua asnjë vizitë studimore në hekurudhat e rajonit ku janë duke u realizuar projekte të ngjashme sikurse rehabilitimi dhe modernizimi i linjës së 10-të hekurudhore tek ne.

**Realizimi i investimeve të parapara nga plani i biznesit** – Gjatë vitit 2019 Departamenti i VET i ka realizuar projektet e parapara me Planin e Biznesit të kompanisë, përfshirë këtu edhe ndërtimin e tri vendkalimeve elektrike në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë e të financuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.

**Realizimi i të hyrave nga qiraja e kabllove optike** - Të hyrat nga qiraja e kabllos optike nga Telekomit i Kosovës përcjellën nga sektori i financave, kurse shërbimi TK i

departamentit bashkëpunon me personat përgjegjës të Telekomit të Kosovës në identifikimin e problemeve që paraqiten përgjatë trasesë së kablllove optike. Kontrata me KONET ka mbetur ende e pa definuar që nga vitit 2011. Përderisa ka punuar kompania KONET dhe kablloptike kanë qenë aktiv, ne e kemi ditur saktë gjendjen e tyre. Ndërsa pas ndërprerjes së punës të KONET-it ne tani e shtatë vite nuk e dimë gjendjen e gypave dhe kablllove optike të cilët nuk janë në funksion.

## Shërbimi i pajisjeve sinjalo siguroese

Shërbimi i pajisjeve sinjalo siguroese merret me mirëmbajtjen e stabilimenteve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt e bëjnë sigurimin e infrastrukturës hekurudhore për qarkullimin e sigurt të trenave. Angazhimi i të gjithë stafit të shërbimit SS gjatë tërë vitit ka qenë në nivelin e duhur ashtu që pajisjet sinjalo siguroese të funksionojnë pa problem.

Ndër shumë e shumë punë të kryera gjatë vitit 2019 në vijim është prezantuar puna e madhe e cila është realizuar në mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, qoftë në mirëmbajtjen e rregullt, qoftë në atë preventive, apo qoftë në eliminimin e pengesave të ndryshme dhe atë:

- Në sinjalet elektrike nëpër të gjitha stacionet e linjës së 10 hekurudhore;
- Brezat izolues për kontrollimin e lëvizjes së trenave;
- Mekanizmat automatik për rrotullimin e skambjeve;
- Ormanët metalik me pajisjet e tyre SS;
- Kokat kabllloptike të binarëve;
- Numëruesit e boshteve dhe detektuesit e trenit;
- Vendkalimet automatike në nivel;
- Kabllot e sinjalizimit,
- Tavolinat komanduese;
- Sistemet e brendshme elektoreleike;
- Sistemet e furnizimit të pajisjeve SS;
- Sistemin e CTC-së; dhe
- Shumë punë dhe detyra tjera sipas nevojave dhe kërkesave.

Nga shumë punë dhe detyra në mirëmbajtjen dhe evitimin e pengesave në pajisjet ss, ky shërbim ka kryer edhe punë tjera tepër të rëndësishme siç është mbikëqyrja e ndërtimit të tri vendkalimeve në nivel rrugë – hekurudhë të cilat janë financuar nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Një punë tejet e rëndësishme e këtij shërbimi është bërë në përcjelljen e projekt dizajnit detaj teknik për rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10-të hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë) ku në mënyrë kontinuale është dhënë mendimi i ekspertëve tanë me komentet përkatëse ku kanë qenë të kyçur të gjithë ekspertët e shërbimit SS dhe ata të shërbimeve tjera.

Përveç rezultateve shumë të mira të cilat janë arritur në shërbimin SS, ky shërbim ka pasur edhe sfidat e veta të cilat e kanë përcjellë gjatë tërë vitit e të cilat ndërlidhen me dëmtimet dhe vjedhjen e pajisjeve të ndryshme SS nga njerëzit e pandërgjegjshëm. Mirëpo, me një angazhim të madh dhe të vazhdueshëm është

bërë tejkalimi i këtyre sfidave, kështu që pajisjet sinjalo sigurose gjatë tërë vitit kanë garantuar qarkullim të sigurt të trenave.



### Shërbimi i pajisjeve telekomunikuese

Shërbimi i pajisjeve telekomunikuese është përgjegjës për mirëmbajtjen e stabilimenteve të telekomunikacionit të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt e bëjnë sigurimin e komunikimit ndërmjet të gjitha njësive, stacioneve dhe personelit të trenave me Qendrën e Kontrollimit të Lëvizjes së Trenave në Fushë Kosovë dhe personat përgjegjës për mbikëqyrjen apo vrojtimin e këtij komunikimi.

Gjatë vitit 2019 shërbimi i telekomunikacionit ka punuar pandërprerë për mirëmbajtjen dhe evitimin e pengesave në sistemet e komunikimit duke e mundur kështu në tërësi komunikimin zyrtar të personelit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e komunikacionit hekurudhor.

Në vijim është prezantuar puna e cila është realizuar në mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve, qoftë në mirëmbajtjen e rregullt, qoftë në eliminimin e pengesave të ndryshme dhe atë:

- ➔ Në centralin digjital telefonik;
- ➔ Rrjetin e telefonisë nëpër të gjitha stacionet hekurudhore dhe nyjën e Fushë Kosovës;

- ➔ Sistemin e kablllove të telekomunikacionit dhe kablllove optike;
- ➔ Aparatet telefonike dhe rrjetin lokal;
- ➔ Antenat dhe pajisjet e radiolidhjeve;
- ➔ Marrësit dhe dhënësit e radiosistemit;
- ➔ Sistemin e video-kamerave në tërë rrjetin hekurudhor;
- ➔ Sistemin e regjistrimit të bisedave të komunikacionit; dhe
- ➔ Shumë punë dhe detyra tjera sipas nevojave dhe kërkesave.

Ndër shumë e shumë punë të realizuara, në vijim janë prezantuar disa nga aktivitetet kryesore në pajisjes e telekomunikacionit gjatë vitit 2019. Do të përmendim këtu mirëmbajtjen aktive të pajisjeve të telefonisë fikse hekurudhore, centralit telefonik digjital dhe pajisjeve tjera përcjellëse në tërë rrjetin hekurudhor.

Një punë jashtëzakonisht e madhe është bërë edhe në mirëmbajtjen e sistemit të radiolidhjeve i cili mundëson komunikimin ndërmjet Qendrës për Kontrollimin e Lëvizjes së Trenave në Fushë Kosovë, Stacioneve hekurudhore dhe makinistave të TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it.

Sistemi i radiolidhjeve funksionon përmes katër antenave të cilat janë të vendosura në Fushë Kosovë, Malet e Berishës, Cërnushë afër Vushtrisë dhe Ivajë afër Kaçanikut. Përmes këtyre antenave mbulohet i tërë Rrjeti Hekurudhor i Kosovës, duke u mundësuar kështu komunikimi njëzetekatërorësh ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve në sistemin e qarkullimit të trenave. Sistemi i radiolidhjeve ka funksionuar në mënyrë të rregullt, me përjashtim të disa problemeve të vogla të cilat kanë ndodhur në momentet e ndërprerjeve të shpeshta të rrymës në antenat e përmendura. Por asnjëherë nuk ka pasur ngecje sepse në raste të ndërprerjeve më të gjata të rrymës është bërë furnizimi i sistemit nga dizel gjeneratorët.



## Shërbimi i pajisjeve të energjetikës

Shërbimi i energjetikës si njëri ndër shërbimet shumë të rëndësishme të INFRAKOS-it gjatë vitit 2019 i ka realizuar me sukses detyrat e planifikuara. Mirëmbajtja e rrjeteve energjetike të tensionit të lartë dhe tensionit të ultë, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve të energjetikës është kryer me sukses.

Shërbimi i energjetikës si gjithnjë ka bërë mirëmbajtjen e pajisjeve energjetike, por në veçanti është marrë me intervenimet në eliminimin e prishjeve të cilat kanë ndodhur në sistemin dhe pajisjet energjetike, sidomos gjatë sezonit dimëror kur shpenzimi i energjisë është dukshëm më i madh. Karshi shumë punëve dhe detyrave të realizuara, në vijim janë prezantuar sferat kryesore të veprimit të këtij shërbimi gjatë vitit 2019:

- ➔ Mirëmbajtja e kabllave energjetike;
- ➔ Mirëmbajtja e trafostacioneve;
- ➔ Mirëmbajtja e dizel gjeneratorëve;
- ➔ Mirëmbajtja e rrjetit të brendshëm të tensionit nëpër ndërtesat e stacioneve, punëtoritë, ndërtesat e stacionit qendror dhe vendet tjera zyrtare; dhe
- ➔ Shumë punë dhe detyra tjera sipas nevojave dhe kërkesave.

Pra, mirëmbajtja e sistemit energjetik të hekurudhës ka kërkuar angazhim të madh dhe kontinual, andaj falë profesionalizmit të stafit të shërbimit energjetik, kjo punë është kryer me sukses.

Në figurat vijuese janë prezantuar disa nga punët e realizuara në pajisjes e energjetikës gjatë vitit 2019, siç [janë dizel gjeneratorët për furnizim rezervë me energji elektrike, rrejtë energjetik i tensionit të lartë dhe kabllot energjetike.



## Përfundim

Përveç detyrave të përshkruara më lartë, Departamenti i VET-së gjatë vitit 2019 ka realizuar edhe shumë punë dhe detyra tjera. Orientimi i këtij departamenti ka qenë dhe mbetet mirëmbajtja e rregullt, mirëmbajtja preventive dhe intervenimi i menjëhershëm në evitimin e pengesave. Kjo është realizuar me të vetmin qëllim që mos të ketë problem në lëvizjen e trenave dhe pajisjet SS, TK dhe EN ta luajnë rolin e vet për çka janë dedikuar.

Marrë parasysh gjendjen ekzistuese të kompanisë, Departamenti i VET-së ka pasur edhe sfida të ndryshme të cilat kanë paraqitur pengesa në realizimin e detyrave. Ndër sfidat kryesore kanë qenë vjedhja e pajisjeve SS, TK dhe EN, uzurpimi i pronës së INFRAKOS-it me ç'rast është bërë dëmtimi i pajisjeve SS, TK dhe EN, dëmtimi i vendkalimeve automatike, problemet e furnizimit me pjesët rezervë dhe sfida të tjera për të cilat ka angazhime të përhershme në eliminimin e tyre.

Përfundimisht, problemi kryesorë ka qenë dhe mbetet çështja e dëmtimit dhe vjedhjes së infrastrukturës hekurudhore, në këtë rast pajisjeve sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe atyre të energjetikës të cilat vjedhje përveç kostos së lartë mund të kenë pasoja edhe në aspektin e sigurisë. Sa për ilustrim, në tabelën vijuese është prezantuar vlera e dëmeve të këtij departamenti nga viti 2005 deri në vitin 2019.

Nr.	Viti i dëmtimeve të pajisjeve SS, TK dhe EN	Vlera e dëmit në euro
1	Viti 2005	127,500.00
2	Viti 2006	307,000.00
3	Viti 2007	207,884.00
4	Viti 2008	424,982.00
5	Viti 2009	125,394.87
6	Viti 2010	21,876.80
7	Viti 2011	22,972.34
8	Viti 2012	11,080.36
9	Viti 2013	46,033.76
10	Viti 2014	109,385.20
11	Viti 2015	31,214.49
12	Viti 2016	60,300.48
13	Viti 2017	38,660.80
14	Viti 2018	36,676.80
15	Viti 2019	33,360.00

## Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit

---

Zyra e planifikim zhvillimit gjatë vitit 2019 ka pasur aktivitete të shumta të lidhura me përmbushjen e detyrave të përcaktuara me planin e biznesit, respektivisht planin e veprimit të kompanisë. Puna aktive në këtë zyre karshi mundësive ekzistuese ka sjellë edhe rezultatet e pritura. Zyra e Planifikim Zhvillimit gjatë vitit 2019 ka trajtuar shumë tema të rëndësishme, duke i bërë analizat dhe studimet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e projekteve të ndryshme në të ardhmen.



Objektivat kryesore të Zyrës për Planifikim dhe zhvillim për vitin 2019 kanë qenë:

- ➔ Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit të zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.
- ➔ Ngritja e bashkëpunimit brenda kompanisë dhe me institucionet vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe modernizimit të linjave hekurudhore.
- ➔ Hulumtimi i zhvillimeve dhe të arriturave në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozimet e mundshme për zbatimin e tyre.
- ➔ Përpilimi i analizave financiare duke u mbështetur në kornizat buxhetore dhe projekte.

Nga punët e realizuara gjatë vitit 2019 në vijim janë përmendur ato më kryesoret:

- ➔ Është bërë hartimi i planit të veprimit për përcaktimin e lokacioneve të vendkalimeve me rrezikshmëri potencialisht më të lartë së bashku me autoritetet e tjera komunale ku graviton hekurudha;
- ➔ Është hartuar analiza e transportit të mallrave dhe të udhëtarëve;

- Është bërë analizimi i rregulloreve dhe mundësitë e harmonizimit të tyre me Direktivat e BE-së;
- Ofrimi mbështetës e profesional në realizimin e hartimit të planit urbanistik të KK Pejës;
- Është bërë mbështetja profesionale në realizimin e hartimit të hartave zonale për KK Podujevë;
- Është hartua një koncept dokument për objektet në linjën hekurudhore Drenas – Pejë ku është përshkruar në mënyrë detaje planimetria e secilit objekt së bashku me një analizë financiare i cili dokument do të na mundësojë ri aplikimin në USAID për mbështetje financiare për ri funksionalizimin e tyre;
- Është hartuar dokumenti për vendkalimet hekurudhore në linja hekurudhore Fushë Kosovë – Aeroport – Medvec;
- Është ofruar mbështetje profesionale për Entin e Statistikave të Kosovës;
- Është hartuar një koncept dokumenti për linjën hekurudhore Klinë - Prizren dhe mundësinë e ri funksionalizimit të saj;
- Janë duke u hulumtuar zhvillimet teknologjike për të hartuar një koncept dokument të digjitalizimit të pronës;
- Është duke u hartuar një koncept dokument mbi gjendjen aktuale dhe evidentimin e eksponateve në “Muzeun e Hekurudhave të Kosovës” si dhe mundësinë e regjistrimit si muze industrial i Kosovës;
- Është duke u punuar në direktivat dhe rregulloret e BE-së për sistemin hekurudhor duke analizuar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin ekzistues të Kosovës; dhe
- Është duke u analizuar dokumentacioni ekzistues rreth vendkalimeve në nivel rrugë hekurudhë, monitorimin e kushteve në të cilat gjendet infrastruktura hekurudhore si dhe sistemin e menaxhimit të aseteve të infrastrukturës hekurudhore.

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim përveç punëve dhe detyrave të përshkuara më lartë, ka vazhduar të kryej edhe punët që janë paraparë në planin e veprimit të kësaj zyreje për vitin 2019, si dhe është angazhuar në punë tjera të nevojshme për nevojat e INFRAKOS-it.

Përkundër sfidave të caktuara, ne mund të konstatojmë se performanca e Zyrës për Planifikim dhe Zhvillim gjatë vitit 2019 ka qenë në nivelin e duhur dhe se kjo zyrë do të vazhdon t'i realizoj me sukses detyrat e parapara edhe në vitin 2020.

## Departamenti i Administratës

---

Departamenti i Administratës ka zhvilluar një aktivitet dhe angazhim të konsideruar edhe gjatë vitit 2019 në përpjekje për të përmbushur objektivat sipas Planit të Biznesit dhe Planit të Veprimit të kompanisë në tërësi. Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara me Planin e Biznesit për vitin 2019.

Me gjithë vështirësitë që jemi ballafaquar prej shumë sfidave të cilat nuk kanë qenë të lehta, falë angazhimit dhe mundit të stafit të Departamentit të Administratës, në këtë periudhë janë realizuar me sukses detyrat e parashtruara.

Sektori i Personelit i ka përmbushur me sukses detyrat e parapara duke bërë administrimin e personelit në mënyrë shumë të mirë, me synim drejt arritjes së objektivave.

Shërbimi i Shkrimore dhe Arkivit edhe gjatë këtij viti janë angazhuar me të gjitha kapacitetet njerëzore dhe profesionale për arritjen e objektivave të parapara.

Shërbimi i Logjistikës ka bërë në mënyrë të rregullt mirëmbajtjen e automjeteve dhe menaxhimin e tyre sipas rregulloreve në fuqi. Sa i përket pastërtisë dhe higjienës në tërësi ka pasur vështirësi për shkak të gjendjes së vështirë financiare gjë që ka ndikuar edhe në furnizimin me material për pastrim.

Shërbimi i Mirëmbajtjes është angazhuar suksesshëm në përmbushjen e detyrave të punës duke bërë mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve, pajisjeve përcjellëse të tyre dhe hapësirave të kompanisë në tërësi.

Përfundimisht, objektivat nga plani i biznesit i Departamentit të Administratës dhe plani i veprimit janë përmbushur në tërësi për vitin 2019 nga të gjithë sektorët dhe shërbimet përkatëse.

### Sektori i resurseve njerëzore

Sektori i resurseve njerëzore ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë vitit 2019 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij sektori dhe departamentit në



tërësi. Në secilin fushëveprim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe kjo është arritur me mjaft sukses. Edhe pse në disa fusha kemi qenë të sfiduar nga departamentet tjera, ne jemi përpjekur që resurset njerëzore punën ta kryejnë në mbështetje të ligjit dhe akteve tjera normative të aplikuara në INFRAKOS.

Në janar të vitit 2019 INFRAKOS-i ka startuar me 311 punonjës dhe 4 (katër) anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Pas lëvizjeve të ndryshme siç janë punësimi, largimi dhe pensionimi, lëvizje këto që janë bërë brenda periudhës prej një viti, me datën 31.12.2019 numri i punonjësve në INFRAKOS ka qenë 300 dhe 6 (gjashtë) anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Vlen të përmendet se angazhimi i këtij sektori ka bërë që të bëhet menaxhimi i suksesshëm i të gjitha detyrave të lidhura me punonjësit tonë.

**Përmbushja e objektivave nga plani i biznesit për vitin 2019** – Sektori i resurseve njerëzore sikurse çdo sektor tjetër i kompanisë, prioritetin numër një e ka pasur realizimin e objektivave të parapara me planin e biznesit. Objektivat e këtij sektori kanë qenë:

- Menaxhimi i rregullt i resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
- Pagat dhe kompensimet tjera të punonjësve;
- Disiplina në punë;
- Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punonjësit dhe palët e Interesuara; dhe
- Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

**Menaxhimi i rregullt i resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi)** - Sektori i resurseve njerëzore gjatë vitit 2019 e ka bërë me sukses të lartë edhe menaxhimin e rregullt sa i përket punësimit, largimit nga puna dhe pensionimit të punonjësve. Gjatë këtij viti janë punësuar 2 (dy) punonjës të ri për ruajtjen e vendkalimit sipas marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve me Kompaninë ndërtimore TREGTIA.

**Ndërprerje e marrëdhënies së punës** – Gjatë vitit 2019 iu është ndërprerë marrëdhënia e punës 16 punonjësve për arsye të ndryshme:

- Përfundim i marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit për dhjetë punonjës;
- Ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkak të vdekjes së punëtorit janë tre punonjës; dhe
- Ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkak të mungesës së gjatë nga puna janë tre punonjës.

**Shkollimi i rregullt dhe periodik, trajnimi dhe zhvillimi i personelit të kompanisë** - Nga lëmia e shkollimit dhe trajnimit për shkak të gjendjes jo të mirë financiare përveç shkollimit të obliguar të punëtorëve ekzekutiv nuk kemi hulumtuar aq shumë mundësitë për trajnim jashtë hekurudhe.

**Disiplina në punë** - Gjatë periudhës një vjeçare me përjashtim të procedurave të largimit të tre punonjësve për shkak të mungesës së gjatë nga puna, nuk kemi pasur asnjë lëndë për komision disiplinor gjë që paraqet një sukses.

**Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara** – Resurset njerëzore në vazhdimësi kanë kryer edhe punët rreth pajisjes së punonjësve, ish punonjësve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe personave të tretë me dokumentacion për nevojat e tyre personale.

**Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore, përcjellja e pushimeve mjekësore dhe pushimeve tjera statusore** - Edhe këtë vit sikurse viteve tjera resurset njerëzore janë marrë me menaxhimin e çështjes së shfrytëzimit të pushimit vjetor dhe pushimeve tjera të punonjësve të kompanisë. Në vitin 2019 shfrytëzimi i pushimeve vjetore ka shkuar pa ndonjë problem të theksuar.

**Shërbimi i Shkrimore** - Shërbimi i shkrimore gjatë kësaj përudhe ka organizuar dhe mbikëqyrë në mënyrë mjaft të suksesshme rregullimin, regjistrimin dhe sistemimin e lëndëve arkivore sipas standardeve dhe ligjit. Në vitin 2019 në zyrën e shkrimore janë administruar gjithsejtë 2618 dokumente të ndryshme si në vijim:

- Kërkesa hyrëse 289
- Lëndët nga gjykata 385
- Fatura hyrëse 841
- Lëndët e punuara brenda dhe shpërndara jashtë 376
- Lëndët punuara brenda dhe shpërndara brenda 249
- Dërgesa me postë 325
- Aplikacione 122
- Kontrata të punonjësve 31

### **Shërbimi i logjistikës**

Shërbimi i Logjistikës ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar gjatë vitit 2019 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij shërbimi. Secila njësi dhe komplet shërbimi ka punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë që jemi ballafaquar në këtë periudhë për shkak të gjendjes së vështirë financiare që kishim.

Gjatë kësaj përudhe me qëllim të reduktimit të shpenzimeve të gjitha veturat janë mbikëqyrur në baza ditore. Shërbimi i logjistikës ka punuar pandërprerë në mirëmbajtjen e automjeteve rrugore të kompanisë, duke përcjellë gjendjen e tyre ditore dhe duke bërë maksimumin e kontrollimit të lëvizjes së tyre. Duke ditur se automjetet të cilat i ka në funksion INFRAKOS-i janë shumë të vjetruara, ne mund të konstatojmë se funksionimi i tyre ka qenë në nivelin e duhur ani se me shumë probleme për mungesë të pjesëve rezervë.

Në kuadër të shërbimit të logjistikës funksionon edhe njësi e pastrimit të objekteve e cila ka për detyrë ta bënë mirëmbajtjen e pastërtisë nëpër objektet e INFRAKOS-it. Gjatë vitit 2019 kjo njësi i ka realizuar me sukses të gjitha detyrat e parashtruara, duke bërë pastrimin e të gjitha zyrave dhe ambienteve tjera të kompanisë, por një punë voluminoze është bërë edhe në pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të jashtme të INFRAKOS-it të cilat ndodhen përreth ndërtesave dhe objekteve tjera në pronësi të kompanisë.

### **Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve**

Shërbimi për mirëmbajtjen e objekteve dhe nxehjes qendrore e ka zbatuar me sukses planin e veprimit për vitin 2019, por në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm

shpeshëherë ka pasur probleme me furnizim me pajisje dhe material për riparimin e objekteve dhe pajisjeve të caktuara.

**Nxehja qendrore** – Një punë shumë e madhe e këtij shërbimi lidhet me mirëmbajtjen e nxehjes qendrore, përgatitjen e pajisjeve, zëvendësimin e kalldajave me të reja dhe furnizimin me ngrohje cilësore për të gjithë shfrytëzuesit e kësaj nxemjeje. Si zakonisht me kohë ëpshtë vepruar në eliminimin e pengesave në mënyrë që gjatë sezonit dimëror të mos ketë problem me nxemje.

**Riparimi i objekteve** – Një punë shumë e madhe gjatë vitit 2019 është bërë në mirëmbajtjen dhe rregullimin e objekteve. Përkundër buxhetit jo të mjaftueshëm, është arritur që të gjitha objektet e INFRAKOS-it të jenë funksionale dhe të ofrojnë kushtet e duhura, apo më mirë të themi kushtet e nevojshme për një ambient të mirë të punës dhe çka është më e rëndësishme për një ambient të mirë për ofrimin e shërbimeve për klientë.

Përfundimisht, përkundër sfidave tejet të mëdha departamenti i administratës gjatë vitit 2019 ka arritur t'i përmbushë shumicën e objektivave të parapara me Planin e Biznesit gjithnjë duke iu falënderuar angazhimit dhe përkushtimit të të gjithë punonjësve të këtij departamenti.

## **Departamenti për pronë dhe standarde**

---

Departamenti për pronë dhe standarde ka pasur një angazhim maksimal gjatë tërë vitit 2019, duke pasur për bazë planin e veprimit të kompanisë dhe realizimin e objektivave të parapara. Angazhimi i të dy sektorëve të këtij departamenti ka qenë maksimal, andaj edhe nuk ka munguar as rezultati i pritur, megjithëse gjithmonë mundet dhe duhet të bëhet më shumë.

### **Spektori i patundshmërisë**

Njëri ndër sektorët më të rëndësishëm për krijimin e të hyrave për INFRAKOS-in është sektori i patundshmërisë i cili merret me menaxhimin e pronës së kompanisë. Angazhimi i përhershëm i këtij sektori ka qenë i orientuar në plotësimin e kërkesave të klientëve tanë, si dhe në ngritjen e të hyrave për INFRAKOS-in. Falë angazhimeve ditore të këtij sektori, nuk kanë munguar as rezultatet e pritura.

Gjatë punës rreth sektorit të pronës duke verifikuar dhe marrë masat e duhura kanë filluar të dalin rezultate të mira të cilat do të kanë ndikim në përmirësimin e të hyrave nga prona.

Gjatë këtij viti përveç punëve të përditshme sektori është ballafaquar edhe me disa probleme tjera ku uzurpator të ndryshëm janë duke e shfrytëzuar pronën e INFRAKOS-it pa marrëdhënie kontraktuale, andaj në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të kompanisë janë marrë të gjitha masat juridike për lirim të pronës duke i dërguar lëndët nëpër gjykata, ndërsa sa i përket borxheve të papaguara lëndët janë dërguar te përmbaruesi privat për ekzekutimin e borxheve të cilat shfrytëzuesit e pronës së INFRAKOS-it nuk i kanë paguar.

Vlen të ceket se gjatë vitit 2019 janë kryer shumë detyra sa i përket pronës, andaj mund të themi se ka pasur një performancë të mirë në këtë sektor. Në emër të ruajtjes së pronës, në gjatë tërë vitit kemi dërguar shumë shkresa edhe në Institucionet më të larta të shtetit siç është Ministria e Infrastrukturës, tek gjykatat dhe tek komunat, duke i njoftuar për punimet në pronën e INFRAKOS-it por prapë kemi pasur ndërhyrje në pronën tonë dhe mos reagim institucional sidomos nga kuvendet komunale në shumë stacione ku graviton hekurudha.

Një punë tejet e vlefshme është bërë edhe në hulumtimin e kënaqshmërisë së klientëve tanë ku dy herë brenda vitit është bërë anketimi i një numri të madh të klientëve, ku në bazë të vërejtjeve të tyre është punuar në eliminimin e të metave. Pra, motoja e jonë kryesore ka qenë dhe mbetet që klientëve tonë të iu ofrojmë shërbime cilësore, ashtu që klientët tonë të janë të kënaqur.

### **Spektori i standardeve dhe sigurisë**

Ky raport përshkruan zhvillimet në përputhje me planin e biznesit të hartuar nga sektori i standardeve dhe sigurisë për vitin 2019 i cili është mbështetur në përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të sektorit të standardeve dhe sigurisë në komunikacionin hekurudhorë dhe që kryesisht mbështetet në përmbushjen e

kërkesave të përgjithshme të sigurisë si objektivi i kompanisë tonë i cili është në përputhje me Ligjin mbi Hekurudhat 04/L-063 dhe Direktivën Evropiane 049/2004 EC

Mbështetur në objektivat dhe planifikimet e sektorit për vitin 2019 Sektori për Standarde dhe Siguri në Komunikacionin Hekurudhorë është mobilizuar dhe ka bërë grumbullimin e materialit të nevojshëm në mënyrë që të hartohet Raporti Vjetor i Sigurisë, ashtu që ky raport të jetë sa më përmbajtësor dhe informues. Ky raport ka qenë gjithëpërfshirës në aspektin e sigurisë me fokus në ngritjen e kulturës së sigurisë në komunikacionin hekurudhor dhe se i ka përmbushur kërkesat dhe formati ka qenë në përputhje me dokumentet e ERA-së.

Po ashtu kemi vazhduar me aktivitetet e përditshme si dhe ato të cilat rrjedhin si rezultat i angazhimit në Njësine për Zbatimin e Projekteve (PIU), ku në mënyrë të veçantë i është kushtuar kujdes monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe ngritjes të nivelit të sigurisë në zhvillimin e komunikacionit dhe mbrojtjes në punë.

Në të shumtën e rasteve e sidomos gjatë zhvillimit të procedurave për blerje dhe furnizime në INFRAKOS, aty ku ka të bëjë me çështje të sigurisë, sektori për standarde ka qenë pjesë e komisioneve të vlerësimit dhe pranimit.

Sektori për Standarde dhe Siguri në Komunikacionin Hekurudhor nuk ka pasur një buxhet i cili do të mbulonte projektet dhe synimet që parashiheshin të zhvilloheshin, me përjashtim të polices së sigurisë e cila u zhvillua në kohën e caktuar sepse kishte për prioritet mbulimin e polices së sigurimit.

### **Njësia për zbatimin e projekteve të rehabilitimit të linjave hekurudhore**

Kjo njësi është marrë me aktivitete në zbatimin e projekteve për rehabilitimin e linjave hekurudhore të financuara nga BERZH-i, BEI-ja dhe grantet e BE-së. Në kuadër të kësaj do të përmendim:

- ➔ Projekti i rehabilitimit të fazës së parë të Linjës 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani Elezit) ka filluar në muajin gusht 2019;
- ➔ Projekt Dizajni për Fazën e dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë), ka përfunduar me sukses dhe pritet edhe miratimi i tij nga BERZH-i
- ➔ Projekti për mbështetjen e PIU-së është përmbyllur me sukses dhe ne tanimë e kemi kompaninë konsulentë mbështetëse të PIU-së;
- ➔ Projekti Preliminar i Linjës së 7-të hekurudhore (Fushë Kosovë - Podujevë ka vazhduar rrjedhën duke realizuar matjet gjeologjike dhe gjeomekanike dhe është përgatitur raporti fillestar. Po ashtu konsulenca ka punuar edhe në ESIA, dhe në trasenë duke bërë inspektimin e urave, tuneleve dhe mbikalimeve dhe nënkallimeve duke konkretizuar draftin e dizajnit preliminarë.
- ➔ Projekti i Studimit të Fizibilitetit dhe Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor për ndërtimin e linjës së Aeroportit po ashtu është afër përfundimit. Janë organizuar takimet me konsulentët dhe palët e treta duke këmbyer informacionet dhe duke sqaruar në detaje kërkesat e tyre.

Sektori për standarde dhe siguri gjatë vitit 2019 ka pasur një angazhim të madh, andaj plani i veprimit për arritjen e objektivave për vitin 2019 duhet të realizohet dhe realizimi i tij duhet të ndihmohet edhe nga sektorët tjerë ngase veprimet janë të ndërlidhura.

## Zyra Ligjore

---

Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë vitit 2019 ka zhvilluar një punë të pandërprerë dhe profesionale të përcjell me intensitet dhe angazhim të lartë. Është bërë një punë me mjaft sakrificë me qëllim të mbrojtjes së pronës dhe infrastrukturës hekurudhore dhe objekteve të kompanisë nga uzurpatorët dhe dëmtuesit, qoftë nga komunat në të cilat shtrihet infrastruktura hekurudhore, apo qoftë nga personat privat. Është bërë një punë e madhe për fitimin e çështjeve të iniciuara në gjykata për realizimin e së drejtës për pagimin e borxhit të qirasë dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara në formë të ndryshme.

Zyra Ligjore gjatë kësaj periudhe ka iniciuar një numër të madh të padive, kallëzimeve penale dhe propozimeve për përmbarim. Kjo zyrë ka pranuar një numër të madh të akteve nga gjykata për çështjet e iniciuara, shkresave nga organet komunale, kërkesa të punëtorëve, individëve të ndryshëm privat si dhe ka bërë një numër të madh të parashtrësive.

Gjatë punës së vet, Zyra Ligjore ka zhvilluar një aktivitet të pandërprerë dhe intensiv në mbajtjen e seancave të treguara nga gjykata për çështjet e iniciuara më parë. Gjatë vitit 2019 ka dominuar çështja e pronës – uzurpimi dhe dëmtimi i pronës që i është bërë infrastrukturës hekurudhore nga komuna e Prizrenit dhe qytetarët e saj, me ç'rast ne kemi bërë iniciimin e mbi 50 kallëzimeve penale për uzurpim dhe dëmtim prone dhe padive për kompensim dëmi. Kallëzimet e paraqitura më parë në përgjithësi janë lejuar nga Prokuroria e Shtetit në Prizren, gjithashtu edhe në gjykatën përkatëse në Prizren, janë duke u zhvilluar seancat gjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit i cili i është shkaktuar infrastrukturës hekurudhore.

E gjithë kjo punë është kryer me angazhimin vetëmohues të zyrtarëve ligjor, gjithnjë duke u bazuar në autorizimet, detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore të akteve të brendshme të ndërmarrjes si dhe zbatimit të dispozitave ligjore.

Në vazhdim është pasqyruar me shifra puna që ka zhvilluar zyra ligjore për periudhën janar – dhjetor të vitit 2019:

### Seancat gjyqësore

Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë vitit 2019 i ka pasur të caktuara 105 seanca gjyqësore nga gjykata, dmth. konteste të natyrave të ndryshme dhe të gjitha këto janë mbajtur dhe kanë qenë të përfaqësuara nga zyrtarët ligjor të autorizuar të kompanisë

### Seancat gjyqësore të zhvilluara kanë qenë të kësaj natyre:

- Civile - 36;
- Penale - 37;
- Kompensim dëmi - 20;
- Përmbarimore - 5;
- Marrëdhënie banesore - 2;
- Marrëdhënie pune – 3; dhe

→ Ndërmjetësimi - 2.

#### **Aktet e arritura për çështjet e iniciuara më parë në gjykata:**

- Aktgjykime - 37;
- Aktvendime - 45;
- Prapësime - 2; dhe
- Urdhër përmbarues - 2.

#### **Parashtresa të punuara :**

- Padi - 3;
- Përgjigje në ankesë - 4;
- Precizim i padisë - 9;
- Fjalë përfundimtare - 4;
- Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë - 1;
- Revizion - 1;
- Përgjigje ne revizion - 3;
- Ankesa - 16;
- Tërheqje e padisë - 4;
- Tërheqje e propozimit për caktimin e MPS - 1;
- Prapësim kundër urdhrit përmbarimor - 14;
- Përgjigje në padi – 5 ;
- Përgjigje në prapësim - 2;
- Kallëzim penal - 1;
- Përgjigje Prokurorisë Themelore në Prizren - 1;
- Plotësim i kallëzimit penal - 1;
- Kërkesë për shtyrje të seancës gjyqësore - 4;
- Propozim për përmbarim - 7;
- Propozim për kthim në gjendje të mëparshme - 1;
- Dërgimi i provave shtese gjykatëse - 2;
- Ndryshim i padisë -1;
- Ndërprerje e procedurës gjyqësore - 1;
- Përgjigje në ekspertizë - 1;
- Plotësim i kundërpadisë - 1;
- Propozim për shtyrje të seancës gjyqësore -1;
- Përgjigje në vërejtje për pagim të taksës gjyqësore - 1;
- Precizim për shpenzimet gjyqësore – 1; dhe
- Taksa të paguara gjyqësore - 8.

Çdo e dhënë e paraqitur në këtë raport ka bazë në një dokument i cili gjendet në dosjen përkatëse me të cilën janë të ngarkuar përfaqësuesit ligjor me çështjet e caktuara, andaj edhe kushdo nga organet kompetente mund të bëjnë verifikimin dhe saktësin e shënimeve në këtë raport për secilën lëndë veç e veç.

## **Departamenti për marrëdhënie me publikun & marketing, shkollim & mbrojtje në punë dhe TI**

---

Gjatë vitit 2019, departamenti i marrëdhënies me publikun, shkollim & mbrojtje në punë dhe teknologji Informativë, ka pasur një angazhim tejet të madh në zbatimin e detyrave të parapara të cilat kanë qenë të përcaktuara me planin e biznesit 2019. Të gjithë sektorët e këtij departamenti kanë qenë në nivelin e duhur për kryerjen e detyrave të tyre.

Punët e këtij departamenti kanë qenë të ndryshme, andaj në drejtim të paraqitjes së një informate të shkurtër në vijim është bërë prezantimi i secilit sektor veç e veç.

### **Zyra për marrëdhënie me publikun dhe marketing**

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing gjatë vitit 2019 vazhdimisht e ka përcjell dhe e ka zbatuar planin e veprimit në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të kompanisë.

Gjatë vitit 2019 kjo zyre i ka përmbushur me sukses objektivat e saj në realizimin e detyrave të parapara të punës së përcaktuar me Planin e Veprimit, duke ndërtuar strategji të pasqyrimin të mediave gjë që ka arritur me sukses pasqyrimin e drejt të proceseve që ka kaluar INFRAKOS-i me theks të veçantë në pasqyrimin e investimeve në sektorin hekurudhor.

Gjatë këtij viti kjo zyrë ka bërë monitorimin e shtypit ditor dhe mediave elektronike, kështu që për periudhën njëvjeçare kemi:

- Shtypi ditor ka pasur 27 artikuj;
- Media elektronike TV dhe portalet e kanë pasqyruar INFRAKOS-in në 68 raste;
- ZMP i ka aranzhuar 19 takime me media lidhur me intervista dhe prononcime
- ZMP dhe media i ka trajtuar 114 raste që kanë të bëjnë me hekurudhat;
- Gjatë kësaj periudhe të gjitha materialet e publikuara në media e që kanë të bëjnë me kompaninë, janë fotokopjuar, printuar dhe ruhen në arkivat e kësaj zyreje së bashku me gazetatat përkatëse;
- Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019 për nevojat e kompanisë janë kryer gjithsej tridhjetë e tri përkthime tekstuale, si dhe përkthimi verbal në shtatë raste duke përfshirë takime dhe vizita të ndryshme.

### **Sektori për shkollim dhe mbrojtje në punë**

Në këtë periudhë kohore menaxhimi i rregullt i sektorit për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë ka qenë në nivelin e kënaqshëm sa i përket menaxhimit dhe implementimit të planit të veprimit gjatë këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe është përcjell Plani i Biznesit për vitin 2019 si dhe janë përmbushur të gjitha detyrat konform akteve të brendshme të kompanisë.

- Është menaxhuar dhe përcjell në vazhdimësi regjistri për kontrollime mjekësore për stafin ekzekutiv. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është përcjellë regjistri i punëtoreve ekzekutiv për grupe shëndetësore se a janë në afate kohore në përputhje me aktet normative në fuqi;
- Është bërë inspektimi në objektet e kompanisë duke filluar nga objekti qendror e më tej ku graviton hekurudha e cila ka pasur rol monitorimi nga aspekti i mbrojtjes dhe sigurisë;
- Është bërë servisimi dhe mbushja e aparateve ekzistuese të zjarrit sipas afateve ligjore;
- Është zbatuar plani i shkollimit për stafin ekzekutiv;
- Është përcjellë në vazhdimësi ngritja e kapaciteteve njerëzore në kuadër të kompanisë.

### Sektori për teknologji informative

Si në çdo sektor tjetër edhe në sektorin e teknologjisë informative është bërë punë e zellshme në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që na obligon plani i biznesit, e sidomos duke qenë në përputhje të plotë me rishikimin e planit të biznesit për periudhën e dytë të vitit 2019.

Ne do t'i paraqesim në disa pika të shkurtra objektivat e sektorit të IT-së, dhe më pas rezultatet nga ky sektor:

- Është bërë mirëmbajtje e rregullte efektive e pajisjeve dhe rrjetit të Teknologjisë Informative;
- Është instaluar, konfiguruar dhe futur në funksion një Firewall fizik i tipit CISCO ASA 5506-K9 në vend të TMG 2010 serverit;
- Janë montuar, instaluar dhe konfiguruar pajisje kompjuterike sipas nevojës dhe kërkesave të zyrtarëve të kompanisë;
- Është bërë përgatitja e specifikacionit për licenca softuerike për vitin 2020 dhe dërgimi i tyre në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit në Ministrinë e Administratës Publike;
- Janë bërë rregullisht “backup and restore” të serverëve;
- Është bërë përditësimi i konzollës të antivirusit Sophos nga versioni 5.3 në 5.5
- Janë instaluar dhe montuar dy invertorë me nga dy bateri prej 100 Ah të lidhur paralel për secilin invertor në dhomën e serverëve;
- Janë publikuar të gjitha kërkesat sipas kërkesave të Menaxhmentit/Departamenteve në ueb-faqen zyrtare të kompanisë [www.infrakos.com](http://www.infrakos.com);
- Është rregulluar serveri i Hyper V-1, për marrje të përditësimeve nga konzolla e WSUS serverit;
- Është bërë fshirja e dokumenteve të vjetra në WSUS Server;
- Është intervenuar në WSUS Server pas problemeve që janë paraqitur me marrje të përditësimeve nga serverët dhe kompjuterët;

- ➔ Është intervenuar në 70% të kompjuterëve që e kanë sistemin Operativ Windows 7 për shkak të marrjes së një përditësimi nga WSUS konzolla që e ka lëshuar Microsofti për instalim në muajin Prill;
- ➔ Në routerin e Cisco pas disa testimeve ia kemi arritur konfigurimit për ndarje të rrjetave (subnetimeve). Kjo do të na lehtësoj punën për të ardhmen;
- ➔ Me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit e kemi vazhduar edhe për tri vite licencën e Sophos Antivirusit në muajin Mars.

Përkundër sfidave të caktuara, falë angazhimeve permanente të stafit të këtij sektori, ne mund të konstatojmë me kënaqësi se objektivat e përcaktuara me planin e veprimtimit 2019 janë realizuar me sukses.

## Kontrollori i brendshëm

---

Viti 2019 për kontrollorin e brendshëm ka qenë vit i angazhimeve të mëdha në kontrollimin e infrastrukturës hekurudhore ku përfshihen pajisjet e Departamentit të Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore (MLH), ato të Departamentit të Veprimtarisë Elektroteknike (VET) dhe pajisjet dhe zbatimimi i detyrave për Departamentin e Komunikacionit.

Gjatë kontrollit në zbatimin e rregulloreve gjatë vitit 2019, kujdes i veçantë i është kushtuar personave nga të cilët varet siguria në transportin hekurudhor, duke filluar nga faktori njeri, intensiteti dhe organizimi i transportit, gjendjes së kapaciteteve teknologjike dhe mirëmbajtjes së tyre, mbikëqyrjes dhe zbatimit të rregulloreve, ngritjes profesionale të punonjësve, disiplinës në punë dhe aplikimit të teknologjisë.

Me rastin e realizimit të kontrollit gjatë tërë vitit 2019 është kërkuar rreptësisht aplikimi i rregulloreve në fuqi, nga se janë me rëndësi të veçantë për vendet e caktuara të punës. Po ashtu gjatë kontrollit janë udhëzuar në funksion edukues si dhe është bërë pasqyrimi i lëshimeve të bëra të shoqëruar me komente mbi pasojat në rast se nuk respektohet edhe më tutje zbatimimi i rregulloreve përkatëse.

Komunikacioni hekurudhor si degë e transportit tokësor është sistem i veçantë dhe me specifikat e veta kërkon nivel të lartë të sigurisë dhe përgjegjësi maksimale. Për arritjen e nivelit të sigurisë dhe mbarëvajtjen e komunikacionit hekurudhor në periudhën e vitit të kaluar janë kryer shumë punë por kanë mbetur pa u kryer edhe punët të cilat kërkojnë afat më të gjatë kohor dhe kanë një kosto të lartë të cilën për momentin INFRAKOS nuk mund ta përballon.

Sa i përket kontrollimit të stafit ekzekutiv mund të konstatojmë se:

- Personeli në shërbimin ekzekutiv ka përgatitjen e duhur profesionale, mirëpo për shkak të moshës së tyre dhe pensionimit kërkohet edhe më tutje përtëritja me kuadro të reja profesionale;
- Kontrollimet shëndetësore kryhen me rregull dhe të gjithë e kanë grupin e kërkuar shëndetësor për vendin e punës ku punojnë;
- Në vendet e punës të shërbimit ekzekutiv mungojnë Rregulloret e domosdoshme teknike në gjuhën shqipe të cilat duhet të hartohen nga ARH-ja;
- Shkollimi i rregullt i punonjësve nëpër vendet e shërbimit, është mbajtur në bazë të plan programit të instruktorit shkollor i përpiluar nga rregullorja 646 dhe rregulloren e punës së INFRAKOS-it
- Zbatimimi i rregullave dhe udhëzimeve për mënyrën e organizimit dhe rregullimit të komunikacionit hekurudhor në rrjetin hekurudhor të HK-ës, është në nivel të kënaqshëm fal përvojës dhe përgjegjësisë së punonjësve në shërbim.

Sa i përket kontrollimit të stacioneve dhe infrastrukturës mund të konstatojmë se:

- Gjendja e objekteve në shërbim të komunikacionit (ndërtesat e stacioneve, punëtoritë dhe ndërtesat e pajisjeve SS, TK & EN), edhe se janë bërë disa

punime në shumë vende kërkohet investim që të krijohen kushtet normale për punë;

- Gjendja e infrastrukturës hekurudhore është mesatarisht e kënaqshme, pasi që angazhimi i pa ndërprerë i departamentit të mirëmbajtjes së linjave, bënë që të jemi të sigurt në realizimin e komunikacionit hekurudhor;
- Gjendja që shihet në teren kërkon të merren masa për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore nga ndërtimet e paligjshme dhe kryerja e intervenimeve funksionale në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës ekzistuese;
- Linjat hekurudhore Klinë - Prizren dhe Bardhosh – Podujevë – kufiri me Serbinë, janë të pakalueshme – pasive;
- Kanalet për kullimin e ujit nga të reshurat atmosferike në të dy anët e linjave hekurudhore, janë pastruar por mbetet akoma punë për tu bërë në këtë drejtim, sidomos në segmentin e vijës së hapur hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit;
- Pajisjet sinjalo siguroese në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë janë jashtë funksionit dhe të dëmtuara gjatë kohës së luftës në Kosovë;
- Janë vendosur një numër i vogël i shtyllave për tregimin e pozitës kilometrike, por një numër i konsiderueshëm i tyre është në – mungesë;
- Shenjat treguese në stacione dhe në tërë rrjetin hekurudhor në masën më të madhe janë të dëmtuara rëndë dhe kërkohet një investim i madh për sanimin e tyre.



Konstatimi i kontrollorit të brendshëm është se angazhimi i të gjithë stafit ekzekutiv në kryerjen e detyrave të mirëmbajtjes dhe organizimit të komunikacionit hekurudhor gjatë vitit 2019 ka qenë në nivel të duhur dhe se për çdo mangësi eventuale të konstatuar janë marrë masat e menjëhershme që aty ku ka qenë e mundur të bëhet eliminimi i tyre.

# 6

## ***Pasqyrat e performancës financiare***

---

<i>Performanca financiare e INFRAKOS-it</i>	<i>66</i>
<i>Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara</i>	<i>67</i>
<i>Shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara</i>	<i>69</i>
<i>Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve</i>	<i>70</i>

---

## Performanca financiare e INFRAKOS-it

Gjendja financiare e INFRAKOS-it në vitin 2019 ka qenë tepër e vështirë dhe angazhimi i jonë gjatë tërë vitit ka qenë i fokusuar në mbikëqyrjen e rreptë të të hyrave dhe shpenzimeve, ashtu që kompania të mund të funksionojë në kushte ta quajmë të jashtëzakonshme. Rënia e të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet për shkak të rënies së transportit të mallrave (për çka përgjegjës është TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i), si dhe mungesa e subvencionimit të kërkuar nga qeveria na ka sjellë në një situatë tejet të vështirë financiare me çka gjatë tërë vitit ka qenë i rrezikuar funksionimi i kompanisë. Bazuar në këtë që u tha më lartë, ne në mënyrë të veçantë kemi pasur angazhime që të menaxhohen me kujdesin më të madh të gjitha llojet e shpenzimeve dhe falë kësaj është arritur që të mos rrezikohet funksionimi i kompanisë.

Është e ditur se të hyrat kryesore të INFRAKOS-it (pagesat e qasjes në rrjet dhe subvencionimi) nuk varen nga ne, andaj kjo ka paraqitur dhe paraqet një sfidë tepër të madhe. Ne në mënyrë të vazhduar kemi shprehur shqetësimin tonë tek institucionet përgjegjëse për mosplotësimin e obligimeve ligjore ndaj INFRAKOS-it, por për fat të keq të gjitha kërkesat tona ndaj këtyre institucioneve edhe gjatë vitit 2019 hasën në vesh të shurdhër. Ne nuk do të dëshironim kurrë që kjo situatë të vazhdojë në mënyrë të njëjtë edhe gjatë vitit 2020, dhe shpresojmë që më në fund institucionet përgjegjëse t'i kryejnë obligimet e tyre ligjore karshi INFRAKOS-it, duke nënshkruar kontratën financiare pesëvjeçare me këtë kompani.

Në tabelën vijuese janë paraqitur në mënyrë të detajuara të gjitha llojet e të hyrave dhe shpenzimeve të INFRAKOS-it gjatë vitit 2019, duke i krahasuar ato me buxhetin e planifikuar të vitit 2019, si dhe duke i krahasuar ato me të hyrat dhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2018.

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve		Realizimi 2018	Realizimi 2019	Buxheti 2019	Diferenca	Diferenca
		A	B	C	B - A	B - C
TË HYRAT	Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit	403,597.87	517,264.19	615,000.00	113,666.32	- 97,735.81
	Të hyrat nga qiraja	647,199.81	694,188.86	720,000.00	46,989.05	- 25,811.14
	Të hyrat tjera	298,885.63	365,321.48	143,000.00	66,435.85	222,321.48
	Subvencionimi i diferencës së rrjetit	586,500.00	999,998.87	2,200,000.00	413,498.87	-1,200,001.13
	Të hyrat e shtyra	914,617.20	1,018,707.28	942,000.00	104,090.08	76,707.28
	<b>Të hyrat totale</b>	<b>2,850,800.51</b>	<b>3,595,480.68</b>	<b>4,620,000.00</b>	<b>744,680.17</b>	<b>-1,024,519.32</b>
SHPENZIMET	Pajisjet	16,892.38	4,937.94	62,000.00	-11,954.44	- 57,062.06
	Harxh. e lokal. ndërtesave	21,147.01	24,846.05	88,530.00	3,699.04	- 63,683.95
	Energjia elektrike	117,984.54	102,240.19	178,000.00	-15,744.35	-75,759.81
	Nafta	46,968.35	35,945.70	68,000.00	-11,022.65	- 32,054.30
	Vajrat, lyerësit, etj.	338.87	74.65	9,000.00	-264.22	- 8,925.35

Materiali harxhues operativ	30,456.71	36,155.51	28,400.00	5,698.80	7,755.51
Riparimet	17,400.63	13,119.18	62,000.00	- 4,281.45	- 48,880.82
Shërbimet operative	1,369.26	1,502.49	3,200.00	133.23	-1,697.51
Udhëtimet zyrtare	9,213.11	6,676.33	41,000.00	- 2,536.78	- 34,323.67
Marketingu dhe publikimet	6,531.33	6,251.60	2,400.00	- 279.73	3,851.60
Mat. i zyrës dhe konsumues	10,958.37	9,104.91	32,850.00	-1,853.46	- 23,745.09
Telefoni / mail / interneti	18,520.01	14,731.58	28,540.00	- 3,788.43	- 13,808.42
Shpenz. e rrezikshmërisë	6,164.52	92,984.14	87,600.00	86,819.62	5,384.14
Reprezentacioni konsumueset	8,780.72	5,046.45	29,300.00	- 3,734.27	- 24,253.55
Sigurimi	9,275.96	8,838.46	52,130.00	- 437.50	- 43,291.54
Stafi i jashtëm	1,587.00	185	12,500.00	- 1,402.00	- 12,315.00
Stafi dhe punëtorët	2,103,503.81	2,079,900.53	2,277,699.10	- 23,603.28	- 197,798.57
Shpenzimet tjera operative	78,752.11	118,016.45	313,850.90	39,264.34	- 195,834.45
<b>Gjithsejtë shpenzimet</b>	<b>2,505,844.69</b>	<b>2,560,557.16</b>	<b>3,377,000.00</b>	<b>54,712.47</b>	<b>-816,442.84</b>
Diferenca (të hyrat -shpenzimet) rez. operativ	<b>344,955.82</b>	<b>1,034,923.52</b>	<b>1,243,000.00</b>	<b>689,967.70</b>	<b>-208,076.48</b>
Amortizimi	1,109,233.79	1,197,807.40	1,222,000.00	88,573.61	- 24,192.60
Shpenzimet tjera financiare	1,124.49	740.53	9,000.00	-383.96	- 8,259.47
<b>Rezultati neto</b>	<b>-765,402.46</b>	<b>-163,624.41</b>	<b>12,000.00</b>	<b>601,778.05</b>	<b>-175,624.41</b>

### Të hyrat e planifikuara dhe ato të realizuara

Sa i përket të hyrave për këtë periudhë kohore e të cilat janë prezantuar në tabelën e mësipërme mund të konstatojmë se të hyrat e planifikuara për fat të keq dhe pa fajin tonë nuk janë realizuar sipas planifikimit. Kjo në mënyrë të veçantë ndërlidhet me të hyrat e subvencionimit nga qeveria të cilat do të duhej të paguheshin në emër të diferencës së pagesave mbi qasjen në rrjet nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i, e të cilat kanë qenë dukshëm më të vogla sesa kërkesa e jonë e cila ndërlidhet me koston direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës. Në vijim do të sqarojmë në mënyrë detaje secilën nga llojet e të hyrave të INFRAKOS-it

**Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit –** Këto të hyra (si të hyrat kryesore të INFRAKOS-it) krijohen nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat i ka bërë TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i në emër të shfrytëzimit të rrjetit dhe sipas Ekspozeut të Rrjetit 2019. Siç shihet nga tabela e mësipërme, në vitin 2019 janë realizuar 517,264.19 € apo 15.89 % më pakë sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 615,000.00 €. Vlen të përmendet se mos realizimi i tërësishëm i të hyrave të planifikuara është si pasojë e mos realizimit të transportit të planifikuar nga operatori i transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS.

Krahasuar me vitin 2018, kur kishim realizuar 403,597.87 €, të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit janë për 113,666.32 € apo 28.16 % më të mëdha. Kjo tregon se të hyrat nga qasja në rrjet kanë rënë në krahasim me buxhetin por kanë një rritje në krahasim me vitin paraprak.

**Të hyrat nga qiraja** – Burimi i dytë i të hyrave të INFRAKOS-it padyshim se janë të hyrat nga qiraja. Gjatë vitit 2019 janë realizuar 694,188.86 € apo 3.58 % më pakë nga shuma e planifikuar për këtë vit e cila kapë vlerën prej 720,000.00 €. Pra, shihet se kemi një rënie shumë të vogël të këtyre të hyrave në vlerën prej 25,811.14 € në krahasim me buxhetin e planifikuar. Krahasuar me vitin 2018 kur kishim realizuar 647,199.81 €, në vitin 2019 të hyrat nga qiraja janë për 46,989.05 € apo 7.26 % më të mëdha.

Ne për vitin 2020 do të bëjmë angazhime maksimale, ashtu që realizimi i të hyrave nga qiraja të jetë edhe më i mirë, kur dihet se ky burim i dyti për INFRAKOS-in sa i përket shumës së të hyrave, deri më tani e ka shpëtuar kompaninë.

**Të hyrat tjera** – Vlen të ceket se realizimi i të hyrave tjera është bërë nga mirëmbajtja dhe riparimet e binarëve privat industrial, ndërtimi i vendkalimeve për kompaninë Bectel – Enka, ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave për të gjithë klientët të cilët e kanë shfrytëzuar atë terminal për ngarkim shkarkimin e mallrave, pastaj ofrimi i shërbimeve tjera dhe shitja e metaleve të vjetra.

Prandaj sa i përket të hyrave të tjera, në vitin 2019 janë realizuar 365,321.48 €, apo 155.47 % më tepër sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 143,000.00 €. Krahasuar me vitin 2018 kur kishim realizuar 298,885.63 €, të hyrat tjera janë për 66,435.85 € apo 22.23 % më të mëdha. Kjo tregon se falë një angazhimi tejet të madh kemi arritur të bëjmë tejkalimin e këtyre të hyrave.

**Subvencionimi nga qeveria** – Ne që nga viti 2012 kemi kërkuar nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Transportit si dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik që të bëjnë subvencionimin e ndryshimit të tarifave nga pagesat e qasjes në rrjet, tarifa këto të cilat INFRAKOS-i i ka përpiluar në bazë të kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës, ndërsa MIT-ja i ka zbritur çdo vit në mënyrë drastike. Për fat të keq asnjëherë deri më sot nuk kemi hasur në mirëkuptim nga institucionet përkatëse që të mbulojnë tërësisht diferencat e kërkuara. Pra, edhe në vitin 2019 ka vazhduar e njëjta praktikë e tri viteve paraprake ku qeveria, respektivisht ministritë përgjegjëse nuk e kanë kryer obligimin për mbulimin e diferencës së pagesave nga qasja në rrjet.

Ne sikurse edhe vitet tjera, bazuar në koston direkte kemi planifikuar një subvencionim real prej 2,200,000.00 € i cili është pritur nga qeveria. Mirëpo, për fat të keq qeveria as këtë vit nuk e bëri subvencionimin e kërkuar duke i ndarë INFRAKOS-it vetëm 999,998.87 €.

Mosgatishmëria e institucioneve përgjegjëse për subvencionimin e plotë të shumës së paraparë, ka ndikuar që ne të bëjmë reduktime të mëdha në shpenzimet e planifikuara gjë që nuk është aspak e mirë sepse pasojat në të ardhmen mundën me qenë të mëdha, duke e cenuar kështu sigurinë e komunikacionit hekurudhor. Kjo do të mund të ketë si pasojë rritjen e aksidenteve të cilat nuk do t'i dëshironte askush, por një gjendje e tillë është e papranueshme për INFRAKOS-in.

Për këtë arsye ne shpresojmë që në vitin 2019, njëherë e përgjithmonë do të nënshkruhet marrëveshja pesëvjeçare financiare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it, me çka njëherë e mirë do të zgjidhet çështja financiare e kompanisë.

Kjo marrëveshje afatgjatë do ta zgjidhte njëherë e përgjithmonë çështjen e financimit të INFRAKOS-it dhe do ta vendoste atë në binarë të sigurt.


Marrëveshja financiare Qeveri – INFRAKOS është e paraparë të bëhet me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063 dhe njëkohësisht një marrëveshje të tillë e nënshkruajnë të gjitha shtetet e BE-së me Menaxherët e tyre të Infrastrukturës, ndërsa investimet apo më mirë të themi subvencionimin të cilin shtetet fqinje e ndajnë për hekurudhën është shumëfish herë më i madh nga subvencionimi i kërkuar nga ana e jonë prej qeverisë.

Për ne është e pa pranueshme edhe logjika e investimeve qeveritare në modernizimin e infrastrukturës hekurudhore (modernizimi i linjës së 10 hekurudhore) nëse nuk subvencionohet kjo infrastrukturë. Pra, të investosh në modernizimin e infrastrukturës dhe të mos financosh kompaninë përgjegjëse për menaxhimin e kësaj infrastrukture, nuk ka asnjë logjikë.

### Shpenzimet e INFRAKOS-it

Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet e realizuara të INFRAKOS-it në vitin 2019 janë 2,560,557.16 €, që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 3,777,000.00 €, janë për 816,442.84 € apo 24.18 % më të vogla. Kjo tregon kujdesin e madh të cilin ne e kemi pasur vazhdimisht gjatë realizimit të shpenzimeve duke bërë kursime maksimale, pasi që e kemi analizuar shumë mirë se nuk do të realizohen të hyrat e planifikuara për arsyet e përmendura më lartë.

INFRAKOS-i gjatë tërë vitit ka bërë me shumë kujdes menaxhimin e shpenzimeve duke kursyer maksimalisht në mënyrë që të mund të bëhet funksionimi i kompanisë. kjo ka rezultuar edhe me vështirësi dhe mungesa të caktuara në furnizime me material dhe pjesë rezervë, mirëpo falë kësaj ne kemi arritur të mbijetojmë dhe ta ruajmë sigurinë e duhur të transportit hekurudhor.



## Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Më lartë është bërë përshkrimi i të hyrave të INFRAKOS-it në krahasim me buxhetin e vitit 2019, si dhe krahasimi i shpenzimeve të realizuara në krahasim me vitin 2018. Vlen të theksohet se INFRAKOS-i është e vetmja kompani publike të hyrat kryesore të të cilës kompani nuk varen nga vetë kompania. Pa marrë parasysh angazhimin maksimal të cilin e ka bërë dhe mund ta bëjë menaxhmenti dhe i gjithë stafi tjetër ndikimi në këto të hyra është tejet minor sepse të hyrat kryesore të INFRAKOS-it varen nga operatorët e transportit hekurudhor.

Në mënyrë që të kemi një sqarim më të detajuar rreth të hyrave dhe shpenzimeve, në tabelën vijuese është bërë paraqitja e të hyrave dhe shpenzimeve totale për vitin 2018 dhe 2019.

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve	Realizimi 2018	Realizimi 2019	Buxheti 2019	Diferenca	Diferenca
	A	B	C	B - A	B - C
Të hyrat totale	2,850,800.51	3,595,480.68	4,620,000.00	744,680.17	-1,024,519.32
Shpenzimet totale	2,505,844.69	2,560,557.16	3,377,000.00	54,712.47	-816,442.84
Diferenca (të hyrat - shpenzimet)	344,955.82	1,034,923.52	1,243,000.00	689,967.70	-208,076.48
Amortizimi	1,109,233.79	1,197,807.40	1,222,000.00	88,573.61	- 24,192.60
Shpenzimet tjera financiare	1,124.49	740.53	9,000.00	-383.96	- 8,259.47
Rezultati neto	-765,402.46	-163,624.41	12,000.00	601,778.05	-175,624.41

Bazuar në tabelën e mësipërme shihet se të hyrat e realizuara në vitin 2019 janë 3,595,480.68 €, që krahasuar me të hyrat e planifikuara 4,620,000.00 €, janë për 1,024,519.32 € apo 22.17 % më të ulëta sesa planifikimi. Krahasuar me vitin 2018 ku kishim realizuar të hyra në vlerën prej 2,850,800.51€, në vitin 2019 kemi realizuar 744,680.17 € apo shprehur në përqindje 26.12 % më shumë.

Nga tabela shihet se shpenzimet e realizuara në vitin 2019 janë 2,560,557.16 €, që krahasuar me shpenzimet e planifikuara 3,377,000.00 €, del se kemi shpenzuar 816,442.84 € apo 24.18 % më pak sesa ka qenë e planifikuar. Kjo diferencë ka ardhur për shkak se ne kemi kursyer gjatë tërë vitit në mënyrë që INFRAKOS-i të mund të operojë pa problem. Pra, është thënë sa e sa herë që ne kemi kursyer maksimalisht për hir të ruajtjes së stabilitetit financiar të kompanisë.

Diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara në vitin 2019 është 1,034,923.52 €, apo shprehur në përqindje del se kemi 36.81 % më shumë të hyra sesa shpenzime. Ky krahasim paraqet rastin kur këtu përfshihen edhe të hyrat e shtyra dhe jo edhe shpenzimet e amortizimit dhe shpenzimet tjera financiare.

Në qoftë se diferencës së të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara në vitin 2019 ia heqim shpenzimet e amortizimit në vlerën prej 1,197,807.40 € dhe vlerën e shpenzimeve tjera financiare 740.53 €, atëherë del se rezultati përfundimtar në vitin 2019 është negativ në vlerën prej 163,624.41 €.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, mund të konstatojmë se viti 2019 ka qenë vit shumë sfidues, por që falë angazhimit të të gjithëve është arritur që të tejkalohet me sukses. Kjo pasqyrë financiare e kompanisë për vitin 2019 nuk është mbresëlënëse, por realiteti ishte i tillë që ne të detyroheshim të vepronim kështu dhe një veprim i vazhdueshëm i punës pa mbështetjen meritore nga qeveria do ta sjellë INFRAKOS-in në pozitë të falimentimit.


Marrëveshja financiare e cila duhet të nënshkruhet ndërmjet Qeverisë dhe INFRAKOS-i, është kërkesë e bazuar në Nenin 63, paragrafin 3, të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04 / L- 063 i cili thotë:

**“Ndërmjet Qeverisë dhe menaxherit në pronësi publike të infrastrukturës ekzistuese të shfrytëzimit të përbashkët INFRAKOS, vendoset marrëveshje kontraktuale. Ajo kontratë duhet të jetë afatgjate, së paku pesë (5) vjeçare dhe duhet të përmbajë strukturën e pagesave të miratuara për financim nga shteti për infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët për tërë periudhën kontraktuale. Qeveria duhet t’i konsultojë të gjitha palët e interesuara së paku (1) një muaj para nënshkrimit të kontratës dhe një (1) muaj pas nënshkrimit duhet ta publikojë nënshkrimin”.**

Bazuar në paragrafin e mësipërm shihet se Qeveria duhet ta nënshkruaj me INFRAKOS-in marrëveshjen financiare pesëvjeçare, marrëveshje kjo e cila është praktikë e të gjitha shteteve të BE-së dhe tani edhe e rajonit.

Në bazë të marrëveshjes pesëvjeçare duhet të bëhet nënshkrimi i marrëveshjeve vjetore me të cilat detajohen të gjitha çështjet rreth financimit dhe përgjegjësi.

Përderisa të mos nënshkruhet marrëveshja financiare pesëvjeçare Qeveri – INFRAKOS, kjo kompani gjithmonë do të ketë një ardhmëri të pasigurt.



# 7

## ***Progresi sipas planit të biznesit***

---

<i>Pasqyrat e progresit në zbatimin e PB-së</i>	<i>73</i>
<i>Progresi i objektivave kryesore strategjike</i>	<i>73</i>
<i>Ndryshimet gjatë aktiviteteve</i>	<i>76</i>

---

## Pasqyrat e progresit në zbatimin e planit të biznesit

Sikurse në vitet paraprake edhe këtë vit objektivi kryesor i INFRAKOS-it ka qenë që të bënë realizimin e tërësishëm të Planit të Biznesit për vitin 2019. Ky plan ka qenë një plan shumë i mirë, i qartë dhe me mundësi të matjes së përhershme të rezultateve të arritura. Si çdo vit tjetër, edhe këtë vit departamentet e kompanisë kanë përpiluar planet e tyre të veprimit duke u bazuar në planin e biznesit, ndërsa në bazë të këtyre planeve është përpiluar plani i veprimit i INFRAKOS-it i cili ka qenë udhërrëfyes për të gjitha departamentet dhe njësitë e kësaj kompanie.

Bazuar në rezultatet e arritura, është konstatuar se Plani i Biznesit 2019 (me përjashtim të realizimit të të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat varen nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i, subvencionimit nga shteti i cili nuk është realizuar sipas kërkesave tona) është realizuar pothuajse tërësisht. Sa i përket të hyrave nga patundshmëria dhe të hyrat tjera, të hyra këto që varen nga ne, këtu vërehet një sukses relativisht i mirë i cili pritet të ketë përmirësim në të ardhmen.

### Progresi i objektivave kryesore strategjike

Sikurse vitin e kaluar, edhe në vitin 2019 realizimi i objektivave të parapara me planin e biznesit ka qenë njëri ndër prioritetet kryesore të INFRAKOS-it. Plani i biznesit i vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime të theksueshme nga ai i vitit 2018. Prandaj, ndër objektivat kryesore të ndërlidhura me pasqyrat e progresit janë këto:

- ➔ Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjisllacionit në fuqi;
- ➔ Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit;
- ➔ Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara;
- ➔ Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jodiskriminuese;
- ➔ Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit të të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija;
- ➔ Fillimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);
- ➔ Realizimi i projekt dizajnit detaj teknik për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë);
- ➔ Përfundimi i projekt dizajnit preliminar për linjën e shtatë hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – kufiri me Serbinë);
- ➔ Përfundimi i studimit të fizibilitetit për linjën hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës);
- ➔ Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë;
- ➔ Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.

Në vijim është prezantuar realizimi, apo mosrealizimi i objektivave të mësipërme të cilat paraqesin bazën kryesore të punëve të INFRAKOS-it gjatë vitit 2019:

**Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislationit në fuqi** – Viti 2019 ka qenë vit i angazhimeve maksimale i departamenteve ekzekutive për ruajtjen e sigurisë në linjat tona hekurudhore. Për këtë arsye, angazhimet e Departamentit të MLH-së kanë qenë kontinuale duke mirëmbajtur linjat hekurudhore në nivelin e kërkuar. Ngjashëm ka bërë edhe Departamenti i VET-së duke i evituar të gjitha pengesat në pajisjet sinjalo – siguroese, telekomunikacionit dhe ato të energjetikës, ndërsa Departamenti i Komunikacionit ka zbatuar me përpikëri orarin e lëvizjes së trenave. Me një fjalë, është bërë punë e madhe duke e ngritur kështu nivelin e sigurisë për qarkullimin e të gjitha llojeve të mjeteve lëvizëse.

**Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit** – Njëri ndër prioritetet tona edhe në vitin 2019 ka qenë ngritja e kapaciteteve njerëzore të kompanisë. Në mënyrë që të mund ta realizojmë vizionin tonë dhe objektivat e parapara me planin e biznesit, njëra nga detyrat kryesore ka qenë dhe akoma mbetet ngritja e kapaciteteve njerëzore.

Për fat të keq në mungesë të mjeteve financiare ne nuk kemi qenë në gjendje që të organizojmë ndonjë trajnim të veçantë, por të organizuara nga stafi i kompanisë janë mbajtur shkollimet dhe testimet e dijes për të gjithë stafin ekzekutiv i cili punon në mirëmbajtje dhe organizim të komunikacionit hekurudhor.

**Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara** – Njëri ndër prioritetet tona edhe në vitin 2019 ka qenë angazhimi i të gjitha resurseve ekzistuese në drejtim të realizimit të të hyrave të parapara. Ne sot mund të konstatojmë se të hyrat të cilat varen nga INFRAKOS-i janë realizuar në kufijtë e paraparë me planin e biznesit, ndërsa si zakonisht ka rënie në të hyrat të cilat varen nga TRAINKOS dhe RAILTRANS. Stafi i jonë ka qenë i angazhuar maksimalisht në realizimin e të hyrave, gjë që ka ndikuar në rritjen e shanseve për përmbyllje të suksesshme të vitit.

**Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jodiskriminuese** – INFRAKOS-i si Menaxher i rrjetit hekurudhor gjatë vitit 2019 përveç operatorit të transportit – TRAINKOS i ka ofruar shërbime edhe operatorit tjetër privat RAILTRANS. Ne me kënaqësinë më të madhe mund të konstatojmë se ofrimi i shërbimeve tona për këta operatorë ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm. Pra, ofrimi i të gjitha shërbimeve tona ndaj operatorëve të transportit ka qenë korrekt, me kohë dhe në nivelin më të lartë të mundshëm.

Ne përgjatë vitit 2019 e kemi bërë testin e kënaqshmërisë për ofrimin e shërbimeve tona dhe me kënaqësi mund të konstatojmë se operatorët e transportit nuk kanë pasur ndonjë vërejtje e cila vlen të përmendet. Sidoqoftë, ne edhe në vitin 2020 do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime cilësore dhe gjithnjë duke i eliminuar mangësitë eventuale.

**Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit të të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija** – Një vëmendje e veçantë gjatë vitit 2019 i kemi kushtuar sektorit të patundshmërisë, sektor ky i cili për INFRAKOS-in krijon të ardhurat kryesore pas qasjes në rrjetin hekurudhor. Me politika të mirëfillta, takime të

rregullta me klientët tanë dhe një qasje shumë të favorshme ndaj tyre, ne kemi arritur që në vitin 2019 të kemi një realizim të tërësishëm të kësaj objektive. Si zakonisht pengesë dhe problem kanë paraqitur mos-pagesat e disa nga klientët tanë të cilët e kanë në shfrytëzim pronën e INFRAKOS-it, por përmes përmbaruesve privat pritet zgjidhja edhe e këtij problemi. Kur jemi te patundshmëria duhet të potencojmë se gjatë vitit 2019 është bërë një punë voluminoze në rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje në pronën e INFRAKOS-it në Komunën e Prizrenit.

**Fillimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit)** – Ky është njëri ndër objektivat më të rëndësishëm të historisë së re të hekurudhave, sepse rehabilitimi dhe modernizimi i linjës së 10 hekurudhore është me rëndësi jetike për integrimin e sistemit hekurudhor të Kosovës në rajon dhe BE. Gjatë vitit 2019 ka filluar rehabilitimi për fazën e parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit), dhe i njëjti është në vazhdim e sipër.

**Realizimi i projekt dizajnit detaj teknik për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë)** – Projekt Dizajni për Fazën e dytë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë), ka përfunduar sipas planifikimit dhe janë në vazhdim e sipër procedurat për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë rehabilitimin gjeneral të këtij segmenti hekurudhor.

**Përfundimi i projekt dizajnit preliminar për linjën e shtatë hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – kufiri me Serbinë)** – Projekt dizajni preliminar për rehabilitimin e Linjës së 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë) ka vazhduar të realizohet gjatë tërë vitit dhe i njëjti është në përfundim e sipër. Pritet që deri në fund të kuartalit të parë të vitit 2020 të bëhet finalizimi i këtij projekti.

**Përfundimi i studimit të fizibilitetit për linjën hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)** - Projekti i studimit të fizibilitetit për linjën hekurudhore të aeroportit po ashtu ka vazhduar të realizohet gjatë tërë vitit por jo me intensitet të dëshiruar dhe i njëjti pritet që të përfundojë gjatë vitit 2020.

**Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë** – Është e ditur se që nga data 03 mars e vitit 2008 forcat paralele Serbe në veri të Kosovës të ndihmuara nga Hekurudhat e Serbisë kanë okupuar pjesën veriore të Linjës së 10 Hekurudhore, duke ia pamundësuar kështu INFRAKOS-it qasjen në atë pjesë të hekurudhës. Ne kishim menduar se gjatë vitit 2019 do të ketë bisedime ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për këtë çështje, por për fat të keq kjo nuk ka ndodhë, gjë që si pasojë nuk është bërë realizimi i këtij objektivi.

Sidoqoftë, ne presim që gjatë vitit 2020 do të ketë lëvizje pozitive dhe se INFRAKOS-i do ta merr nën menaxhim edhe atë pjesë së linjës hekurudhore, ashtu që të mund të iu ofrojë shërbime të transportit operatorëve hekurudhorë edhe në veri të Kosovës.

**Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë** – Edhe këtë vit, mund të konstatojmë me kënaqësi se INFRAKOS-i ka mbajtur dhe zhvilluar një aktivitet të

shkëlqyer të bashkëpunimit me institucionet vendore, rajonale dhe ato të BE-së. këtu vlen të potencohet angazhimi i jonë maksimal në dhënien e informatave, hartimin e raporteve, plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm dhe zhvillimin e komunikimit permanent me të gjitha institucionet tona shtetërore (në veçanti me Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Integritetit dhe Ministrinë e Financave), me institucionet rajonale (në veçanti me hekurudhat Maqedonase, të Shqipërisë dhe ato të Malit të Zi), dhe së fundmi me institucionet e BE-së (në veçanti me BERZH-in, BEI-në, WBIF-in, CER-in), e kështu me radhë.

Këtu veçanërisht vlen të përmendet angazhimi i jonë në Komitetin Teknik mbi Hekurudhat të themeluar sipas Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor ku në tri takimet e mbajtura gjatë vitit 2019 ne kemi qenë shembull për vendet tjera të rajonit.

Ne gjithsesi që gjatë vitit 2020 do të zhvillojmë edhe më shumë komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përmendura dhe palët e interesit, gjithnjë në drejtim të zhvillimit të sistemit hekurudhor të Kosovës.

### **Ndryshimet gjatë aktiviteteve**

Si zakonisht edhe për vitin 2019 ne kemi hartuar planet e veprimit të bazuara në Planin e Biznesit të kompanisë. Këto plane kanë qenë mjaft të detajuara, mirëpo bazuar në rrjedhat ditore dhe kushtet ekzistuese, është dashur që të bëhen improvizime të caktuara duke bërë edhe ndryshimin e prioriteteve apo kohës së zbatimit të projekteve të caktuara. Duke dashur që ta ruajmë sigurinë financiare të kompanisë, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm edhe në zbatimin e projekteve të planifikuara dhe kohës së zbatimit të tyre. Për shkak të situatës jo të mirë financiare ne kemi bërë edhe ndryshime të caktuara nga plani paraprak.

Ndryshimet e Planit të Biznesit për vitin 2019, kanë ardhur si pasojë e moszgjidhjes së problemeve kyçe të kësaj kompanie nga institucionet përgjegjëse të shtetit, dhe assesi si pasojë e mos-punës së INFRAKOS-it. Ne nuk do të dëshironim që situata e vitit 2019 të përsëritet edhe në vitin 2020, prandaj edhe njëherë apelojmë tek qeveria që gjatë vitit 2020 të nënshkruhet marrëveshja financiare pesëvjeçare e kërkuar nga ne me vite të tëra.

# 8

## ***Shpenzimet kapitale dhe projektet***

---

<i>Projektet e financuara nga Buxheti i Kosovës</i>	78
<i>Projektet e financuara nga INFRAKOS-i</i>	79

---

## Shpenzimet kapitale dhe projektet

Departamenti i prokurimit gjatë vitit 2019 ka qenë i angazhuar maksimalisht në realizimin e projekteve të parapara me planin e biznesit. Problemi kryesor gjatë këtij viti ka qenë mungesa e mjeteve financiare, kështu që një numër i projekteve të cilat do të duhej të financoheshin nga buxheti i kompanisë nuk janë realizuar.

Sa i përket projekteve të financuara nga Buxheti i Kosovës, vlen të ceket se kërkesa e jonë për projekte kapitale ka qenë shumë më e madhe, por për fat të keq në vend të rritjes së buxhetit, qeveria ka bërë reduktimin e mjeteve financiare të ndara për financimin e projekteve kapitale.

Departamenti i prokurimit ka vepruar në mënyrë aktive gjatë tërë vitit duke i pranuar me kohë të gjitha kërkesat për furnizim nga sektorët kërkues të INFRAKOS-it dhe duke i realizuar këto kërkesa sipas prioriteteve të menaxhmentit dhe situatave ekzistuese. Përkushtimi kryesor ka qenë që të zbatohen të gjitha procedurat e përcaktuara ligjore për furnizim, gjë që është kryer pa problem dhe për çdo lloj të furnizimeve.

### Projektet kapitale nga Buxheti i Kosovës

Sikurse edhe në vitin 2018, kërkesat dhe realizimi i projekteve kapitale të INFRAKOS-it gjatë këtij viti kanë qenë në nivelin e duhur. Departamenti i prokurimit kishte bërë me kohë kërkesat tek njësitë kërkuese që të bëjnë përpilimin e kërkesave të tyre për publikimin e tenderëve për projektet kapitale të përcaktuara me buxhetin e shtetit për vitin 2019. Falë angazhimit të departamenteve përkatëse dhe departamentit të prokurimit, mund të vlerësojmë se realizimi i këtyre projekteve është bërë me sukses. Si zakonisht departamenti i prokurimit ka pasur angazhim maksimal që projektet e parapara me Buxhetin e Kosovës të realizohen me sukses, andaj me angazhimin maksimal të të gjitha palëve të interesit është arritur që objektivat tona të caktuara për vitin 2019 të realizohen me sukses.

Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i projekteve të realizuara gjatë vitit 2019 të financuara nga Buxheti i Kosovës.

Nr.	Emërtimi i projektit	Vlera e paguar
<b>1</b>	<b>Furnizimi me pjesë rezervë të infrastrukturës</b>	
1.1	Furnizimi me pjesë dhe pajisje për mirëmbajtjen e sistemit të sinjalizimit.	21,585.74
1.2	Furnizimi me pjesë dhe pajisje për mirëmbajtjen e sistemit të telekomunikacionit.	16,997.78
1.3	Furnizimi me pjesë dhe pajisje për mirëmbajtjen e sistemit të energjetikës	3,833.23
1.4	Furnizimi me pjesë dhe pajisje për mirëmbajtjen e sistemit të teknologjisë informative	13,755.96

<b>2</b>	<b>Furnizimi me makina, pajisje dhe mjete pune për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore</b>	
2.1	Furnizimi me makinë për rregullimin e drejtimit dhe niveletës së binarit (projekt në vazhdim)	743,302.15
<b>3</b>	<b>Mbrojtja e vendkalimeve rrugë – hekurudhë</b>	
3.1	Ndërtimi i tri vendkalimeve elektrike në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë, projekt i financuar nga Ministria e Infrastrukturës de Transportit	541,049.09
<b>T O T A L I</b>		

### Furnizimet nga buxheti i INFRAKOS-it

Gjatë vitit 2019 krahasuar me vitet paraprake janë realizuar një numër shumë më i vogël i furnizimeve nga buxheti i INFRAKOS-it, duke u nisur nga materialet shpenzuese e deri te pjesët rezervë për mirëmbajtjen e stabilimenteve të ndryshme të infrastrukturës. Vlen të potencohet se departamenti i prokurimit ka pasur një kujdes të veçantë që të gjitha furnizimet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi. Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i numrit të projekteve të realizuara në vitin 2019 dhe të financuara nga buxheti i kompanisë.

<b>Furnizimet e realizuara nga buxheti i INFRAKOS-it</b>	Numri i projekteve	Vlera e kontratave
	42	79,102.87

INFRAKOS-i edhe në vitin 2019 ka qenë shumë aktiv në realizimin me kohë dhe të suksesshëm të projekteve kapitale të financuara nga shteti, por edhe atyre të financuara nga buxheti i kompanisë Prandaj ne besojmë që në vitet në vijim vlera e projekteve kapitale do të rritet dukshëm, por edhe mundësia financiare e INFRAKOS-it për zhvillimin e projekteve të nevojshme të kompanisë.

# 9

## ***Perspektiva për vitin e ardhshëm***

---

<i>Objektivat kryesore sipas planit të biznesit 2020</i>	<i>81</i>
<i>Ndryshimet nga plani i biznesit i vitit paraprak</i>	<i>82</i>

---

## Perspektiva për vitin 2020

Viti 2019 ka qenë vit i zhvillimeve të rëndësishme, por edhe viti më sfidues për INFRAKOS-in. Kur themi se ka qenë vit i zhvillimeve të mëdha, këtë e bazojmë në një numër të madh dhe shumë të vlefshëm të projekteve të cilat janë kryer apo kanë filluar të zbatohen:

- ➔ Ka filluar rehabilitimi i fazës së parë të Linjës së 10-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);
- ➔ Ka përfunduar projekt dizajnit detaj teknik për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë);
- ➔ Ka vazhduar realizimi i Projekt Dizajnit Preliminar për rehabilitimin e Linjës së 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë);
- ➔ Ka vazhduar studimi i fizibilitetit për Linjën Hekurudhore Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës.

Pra, zhvillimet të cilat kanë ndodhur në vitin 2019 garantojnë një ecje të hovshme të INFRAKOS-it edhe në vitin 2020. Ne jemi të vetëdijshëm se çështja financiare e kompanisë tonë do të jetë e vështirë edhe në vitin 2020, sepse nuk pritet rritje e transportin nga operatorët hekurudhor dhe do të jetë problematike edhe nënshkrimi i kontratës financiare pesëvjeçare me qeverinë. Sidoqoftë, ne besojmë se perspektiva e INFRAKOS-it për vitin 2020 do të jetë dukshëm më e mirë, andaj në vitin 2020 presim zhvillimet vijuese:

- ➔ Vazhdimin e punëve në rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);
- ➔ Fillimin e punëve në rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10 Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë);
- ➔ Finalizimin e Projekt Dizajnit Preliminar për Rehabilitimin e Linjës së 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë);
- ➔ Finalizimin e studimit të fizibilitetit për Linjën Hekurudhore Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës.
- ➔ Nënshkrimin e kontratës financiare pesëvjeçare (2021 – 2025) ndërmjet Qeverisë dhe INFRAKOS-it.

Pra, nga prezantimi i projekteve të sipërpërmendura vërehet se viti 2020 do të jetë një vit tejet i ngarkuar me punë dhe projekte të cilat ne do të bëjmë çmos që t'i realizojmë me sukses. Realizimi i këtyre projekteve garanton një perspektiv shumë të mirë të INFRAKOS-it, perspektivë kjo e cila këtë kompani do ta qoj drejt zhvillimeve të reja dhe një sukseesi të garantuar.

## Objektivat kryesore sipas Planit të Biznesit për vitin 2020

Tanimë dihet se viti 2020 sikurse edhe viti paraprak do të jetë vit i zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore dhe projekteve tjera të rëndësishme. Në vijim janë paraqitur objektivat tona për këtë vit të cilat janë marrë nga Plani i Biznesit për vitin 2020. Prezantimi i këtyre objektivave nuk ka ndryshime qenësore nga ato të vitit paraprak, sepse ndërlihdja e tyre me sistemin hekurudhor është e shkëlqyer, ndërsa realizimi i tyre është çdoherë i mundur.

Pra për vitin 2020 ne kemi përcaktuar objektiva të qarta të cilat do të mundësojnë zhvillimin më të hovshëm të kompanisë. Ndër objektivat e shumta do të përmendim këto:

- ➔ Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin më të lartë të mundshëm konform rregullativave dhe legjislacionit në fuqi.
- ➔ Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit.
- ➔ Angazhimi maksimal në menaxhimin e mirë të resurseve ekzistuese për realizimin e të hyrave të parapara.
- ➔ Ofrimi i traseve hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor në mënyrë korrekte, transparente dhe jodiskriminuese.
- ➔ Menaxhimi i mirëfilltë i patundshmërisë si resursi i dytë i krijimit të të hyrave dhe eliminimi i borxheve të këqija
- ➔ Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së parë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit).
- ➔ Fillimi i rehabilitimit dhe modernizimit të fazës së dytë të Linjës së 10 hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë).
- ➔ Përfundimi i projekt dizajnit preliminar për linjën e shtatë hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – kufiri me Serbinë)
- ➔ Përfundimi i studimit të fizibilitetit për linjën hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)
- ➔ Rihapja e pjesës veriore të Linjës së 10 hekurudhore nga Mitrovica në kufirin me Serbinë.
- ➔ Ngritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare drejt zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.

INFRAKOS-i do të ketë një angazhim maksimal gjatë tërë vitit 2020 ashtu që objektivat e sipërpërmendura dhe të përcaktuara me planin e biznesit të realizohen me sukses.

### **Ndryshimet nga plani i biznesit i vitit paraprak**

Plani i biznesit për vitin 2020 u tha edhe më lartë se është shumë i ngjashëm me atë të vitit paraprak, ndërsa edhe objektivat e paraqitura në këtë plan nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të madh që vlen të potencohet.

Ngjashëm me vitin paraprak, objektivat në Planin e Biznesit të vitit 2020 janë shumë të qarta, duke filluar nga objektivat bazike të cilat përsëriten vazhdimisht e deri tek objektivat e reja të cilat janë futur në këtë plan të biznesit. Në këtë kontekst, mirëmbajtja e infrastrukturës, ngritja e sigurisë dhe kapacitetet njerëzore, ofrimi i shërbimeve të qasjes në rrjet dhe realizimi i të hyrave nga patundshmëria, mbesin akoma si objektivat kryesore të INFRAKOS-it edhe për vitin 2020.

Pra, marrë në tërësi, ndryshimet e Planit të Biznesit të vitit 2020 në krahasim me atë të vitit 2019 janë shumë të vogla dhe ndërlidhen vetëm me zbatimin e projekteve infrastrukturore.


---

<i>Rreziqet në dy vitet e ardhshme</i>	84
<i>Komentimi i rreziqeve</i>	85
<i>Si të veprohet</i>	87

---

## Rreziqet për të ardhmen

Sfidat të cilat e kanë përcjellë INFRAKOS-in në vitet e kaluara, e sidomos në vitin 2019 kanë qenë tepër të mëdha (kuptohej sa i përket gjendjes financiare), andaj falë parashikimeve tona paraprake dhe angazhimit maksimal, arritëm të mbijetojmë edhe vitin 2019. Kjo gjendje e vështirë financiare nëse nuk do të nënshkruhet kontrata financiare me qeverinë, pritet të vijojë edhe në vitin 2020. Sipas analizave tona, rreziqet në vitet e ardhshme janë të ndikuara dhe varen nga shumë faktorë të



ndryshëm në shumicën prej të cilëve ndikimi i INFRAKOS-it është shumë i vogël apo të themi zero. Për këtë arsye, përveç angazhimeve maksimale të INFRAKOS-it në eliminimin e rreziqeve, do të duhet që urgjentisht të angazhohen edhe të gjitha institucionet tjera relevante (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik) ashtu që infrastruktura

hekurudhore t'i eliminojë tërësisht apo t'i zvogëlojë maksimalisht këto rreziqe në mënyrë që rrjeti hekurudhor të jetë në nivelin e duhur dhe INFRAKOS-i të mund të ofrojë shërbime cilësore.

## Rreziqet kryesore në dy vitet e ardhshme

INFRAKOS-i me planin e biznesit përmes SWOT analizës i ka përcaktuar qartë dhe në detaje rreziqet me të cilat mund dhe përballohet kompania e jonë. Në të njëjtën mënyrë është bërë edhe plani i veprimit përmes të cilit janë përcaktuar aktivitetet për eliminimin apo minimizimin e këtyre rreziqeve. Bazuar në përvojat e viteve paraprake ne i kemi përcaktuar qartë rreziqet kryesore të cilat do të mund ta cenojnë kompaninë në dy vitet e ardhshme.

Meqenëse rreziqet për dy vitet e ardhshme janë thujse tërësisht të ngjashme me ato të trajtuara në raportin e vitit 2019, ne nuk kemi bërë ndryshime të përcaktimit të rreziqeve për vitin 2020, andaj është normale që edhe në dy vitet vijuese përafërsisht do të mbesin të njëjtat rreziqe:

- ➔ Mosfunksionimi i mirë i TRAINKOS-it;
- ➔ Mosfunksionimi i mirë i RAILTRANS-it;
- ➔ Humbja e klientëve të patundshmërisë;
- ➔ Mos subvencionimi i INFRAKOS-it;
- ➔ Financimi jo i mjaftueshëm i projekteve kapitale të infrastrukturës;
- ➔ Mosnënshkrimi i kontratës për financimin e INFRAKOS-it nga qeveria;
- ➔ Pamundësia e rihapjes së linjës veriore Mitrovicë – Leshak – Serbi;

- ➔ Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionit; dhe
- ➔ Dëmtimi dhe uzurpimi i infrastrukturës hekurudhore;

### **Komentimi i rreziqeve**

Nga një numër i konsideruar i rreziqeve, ne kemi përzgjedhur rreziqet e mësipërme të cilat mund të ndikojnë negativisht në performancën e kompanisë. Këtu kemi parashtruar vetëm rreziqet të cilat konsiderohen si më të mëdha, dhe të cilat kanë ndikim kryesor në zhvillimin e INFRAKOS-it dhe performancën në tërësi. Secili nga rreziqet e përmendura mund ta rrezikon funksionimin normal të INFRAKOS-it, andaj edhe do të analizohen veç e veç.

**Mosfunksionimi i mirë i TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it –** Rënia e transportit të mallrave dhe ndërprerja e qarkullimit të disa nga trenat e udhëtarëve nga ana e TRAINKOS-it që në vitin 2018, nuk pritet të ndryshohet as gjatë vitit 2020. Startimi i dobët i operatorit privat të transportit RAILTRANS, paraqet të njëjtin rrezik të vazhdimit të gjendjes së njëjtë edhe gjatë vitit 2020. Meqenëse të hyrat kryesore të INFRAKOS-it varen nga këta dy operator të transportit, atëherë mosfunksionimi i mirë i tyre paraqet rrezik permanent për kompaninë tonë edhe gjatë vitit 2020. Prandaj, menaxhmenti i TRAINKOS-it, por edhe pronari i RAILTRANS-it do të duhej të angazhohen maksimalisht në gjetjen e mundësive për rritje të transportit të mallrave, sepse kjo do të ishte në dobi të kompanive të tyre por njëkohësisht edhe të INFRAKOS-it i cili do të kishte të hyra më të mëdha nga pagesat e qasjes në rrjet.

**Humbja e klientëve të patundshmërisë –** Pas të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet të cilat realizohen nga TRAINKOS-i dhe RAILTRANS-i, të hyrat tjera kryesore të INFRAKOS-it realizohen nga patundshmëria, respektivisht dhënia e kësaj patundshmërie me qira për zhvillimin e bizneseve të ndryshme. Gjatë vitit 2019 të hyrat e realizuara nga patundshmëria kanë qenë sipas planit të paraparë. Mirëpo, duke marrë parasysh situatën e rëndë ekonomike në vend dhe rënien bizneseve private, një rrezik tjetër permanent për kompaninë paraqet edhe mosrealizimi i të hyrave të planifikuara nga patundshmëria e cila mund të vjen si shkak i gjendjes së vështirë ekonomike dhe humbjes së klientëve ekzistues.

**Mos subvencionimi i INFRAKOS-it –** INFRAKOS-i shpenzon mjete të mëdha në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, mjete këto të cilat duhet të mbulohen nga pagesat e qasjes në rrjet nga ana e operatorëve hekurudhor. Është e ditur se të gjithë menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të vendeve të rajonit, por edhe ata të BE-së, subvencionohen nga shteti me shuma të mëdha të parave. Rasti i jonë fatkeqësisht paraqet akoma një çështje të pazgjidhur si e sa duhet. Mbulimi i diferencës ndërmjet kostove direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe pagesave të qasjes në rrjet akoma nuk e ka zgjidhjen e kënaqshme. Andaj, mos-subvencionimi i tërësishëm nga shteti i kësaj diference paraqet rrezik për INFRAKOS-in edhe në vitin 2020.

**Financimi jo i mjaftueshëm i projekteve kapitale të INFRAKOS-it –** Me Planin e Biznesit të vitit 2020, janë përcaktuar qartë edhe projektet zhvillimore të kompanisë. Meqenëse gjendja financiare e kompanisë nuk është e mirë, kjo në mënyrë

automatike e pamundëson investimin në projekte kapitale nga financimi vetanak. Lidhur me këtë ne kemi kërkuar dhe kërkojmë nga institucionet përgjegjëse që të bëjnë financimin e këtyre projekteve zhvillimore të INFRAKOS-it. Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë do të kemi një rrezik të mosfunksionimit normal të kompanisë, gjë që do të rezultonte me cenimin e sigurisë në transportin hekurudhor.

**Mosnënshkrimi i kontratës për financimin e INFRAKOS-it nga Qeveria –** Një rrezik tepër i madh i cili po përcillet që katër vite paraqet mosnënshkrimi i kontratës financiare pesëvjeçare ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe INFRAKOS-it. Kjo kontratë e cila është e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat, paraqet një domosdoshmëri për funksionimin normal të kompanisë dhe ruajtjen e një stabiliteti financiar në staza më të gjata. Ne kemi shpresë se gjatë vitit 2020 do të bëhet nënshkrimi i kësaj kontrate të shumëpritur me ç'rast njëherë e përgjithmonë do të zgjidhet problemi financiar i INFRAKOS-it.

**Pamundësia e rihapjes së linjës veriore Mitrovicë / Leshak / Serbi –** Është e ditur se linja hekurudhore Mitrovicë - Leshak është e bllokuar nga serbët e veriut që nga viti 2008. Kjo ka pasur zhvillim negativ në të dyja vendet dhe për këtë kërkesat dhe nevojat e rihapjes së kësaj linje hekurudhore janë shumë të mëdha. Rihapja e kësaj linje hekurudhore do të mundësonte një zhvillim shumë më të madh të transportit hekurudhor dhe Kosovës do t'i mundësohej edhe një qasje hekurudhore në shtetet e rajonit, në këtë rast në rrjetin e Serbisë. Rreziku i vazhdimit të situatës së njëjtë edhe në vitin 2020 është i madh, andaj pritet një angazhim më i madh i institucioneve tona përgjegjëse në zgjidhjen e këtij problemi.

**Kostoja e lartë e investimeve për rehabilitimin e linjave jashtë funksionit –** Një problem të veçantë për biznesin hekurudhor ka paraqitur pamundësia e futjes në funksion të tërë rrjetit hekurudhor. Interesimi i jonë gjatë vitit 2020 është që të gjejmë mundësinë e futjes në funksion të linjave të cilat që nga viti 1999 janë jashtë funksionit. Fjala këtu është për linjën Prishtinë – Podujevë dhe atë Klinë - Xërxe – Prizren të cilat për shkak të dëmtimeve tepër të mëdha janë jashtë funksionit. Kostoja e lartë e rehabilitimit të këtyre linjave është faktori kryesor i cili rrezikon mosfunksionimin e tyre, andaj mbetet që qeveria të gjejë mjetet e nevojshme për rehabilitimin e këtyre linjave. Falë angazhimeve tona, gjatë vitit 2020 pritet të finalizohet projekt dizajni preliminar për linjën e Podujevës, ndërsa rreziku qëndron në mos gjetjen e mjeteve financiare për rehabilitimin e kësaj linje hekurudhore në të ardhmen.

**Dëmtimi dhe uzurpimi i infrastrukturës hekurudhore –** Dëmtimet e mëdha dhe uzurpimet nëpër vite të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës kanë qenë njëra ndër brengat dhe sfidat tona kryesore. Dëmtimi dhe vjedhja e kësaj infrastrukture ka vazhduar me një ritëm të njëjtë edhe gjatë vitit 2019, gjë që INFRAKOS-in e kanë sjellë në një situatë tejet të vështirë, ku përveç dëmeve materiale rrezikohet edhe siguria e komunikacionit hekurudhor.

Përveç dëmtimeve, një çështje shumë brengosëse paraqesin edhe uzurpimet e ndryshme të cilat i bëhen infrastrukturës hekurudhore nga personat e pandërgjegjshëm fizik dhe juridik. Kjo është një dukuri e cila përcillet nëpër vite dhe për fat të keq infrastrukturës hekurudhore i ka shkaktuar dhe i shkaktton dëme të pakompensueshme. Ne kemi pasur dhe do të kemi angazhime të shumta në

mbrojtjen e infrastrukturës tonë, mirëpo në qoftë se institucionet tona nuk i mbështesin veprimet tona, atëherë rreziku i vazhdimit të kësaj storie jo të mirë do të jetë prezent edhe gjatë vitit 2020

### Si të veprohet

Duke parë se rreziqet e mosfunksionimit të pritur të INFRAKOS-it janë të mëdha, ne me kohë kemi hartuar planet tona dhe në bazë të tyre planet e veprimit, ashtu që rreziqet e përmendura t'i zvogëlojmë në minimum apo t'i eliminojmë në tërësi. Zotimi i menaxhmentit të INFRAKOS-it është që të punojë pa ndalë për përmbushjen e Planit të Biznesit për vitin 2020 dhe objektivave që dalin nga ky plan. Ne jemi të vetëdijshëm për situatën ekzistuese ekonomike të vendit dhe problemet e mëdha të cilat i ndjekin të gjitha vendet e rajonit, por ne jemi të vetëdijshëm se pa sakrificë nuk ka as sukses. Andaj zotimi i jonë është se në vitin 2020 do të bëjmë sa vijon:

- Realizimin e plotë të planeve tona të veprimit të dala nga Plani i Biznesit;
- Bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha palët e interesit;
- Përmirësimin e dukshëm të angazhimeve tona në arritjen e rezultateve më të mira, duke realizuar kështu synimet tona por me një kosto më të vogël;
- Hulumtimin e vazhdueshëm të mundësive të gjetjes së investimeve dhe mundësive të reja të përmirësimit të infrastrukturës;
- Mbrojtjen e asetëve dhe infrastrukturës hekurudhore;
- Zhvillimin e projekteve të ndryshme të patundshmërisë;
- Realizimin e menjëhershëm të detyrave tona rreth rehabilitimit gjeneral të linjës së 10 hekurudhore; dhe
- Ngritjen në maksimum të kujdesit ndaj sigurisë në komunikacionin hekurudhor.

INFRAKOS-i gjatë vitit 2020 do të ketë angazhime tejet të mëdha, qoftë në realizimin e detyrave ditore, qoftë në realizimin e projekteve zhvillimore, ndër të cilat do të veçojmë rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e Linjës së 10 Hekurudhore.

Si zakonisht dhe mbi të gjitha, si prioritet numër një do të jetë siguria e linjave tona hekurudhore, gjë që në këtë drejtim ne si gjithmonë do të jemi të pa kompromis dhe nuk do të lejojmë asnjëherë që linjat tona të mos kenë nivelin e duhur të sigurisë. Pra, puna e jonë dhe e tërë stafit të hekurudhës me angazhim maksimal do të vazhdojë edhe vitin 2020, por edhe në vitet tjera në vijim.

Për fund, ne garantojmë se me të njëjtin elan do të vazhdojmë punën e pakursyer edhe në vitin 2020, ashtu që Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës të jetë pjesë e rrjetit të vendeve të rajonit dhe Rrjetit të Integruar të vendeve të BE-së.

Fund